



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 365 Akti

Nr. 520 Vendimi
Tiranë, më 30.3.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Pamela Qirko	Relatore
Etleđa Çiftja	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, zotit Francesco Ciardi, në datën 28.3.2022, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*) Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Taulant Banushi**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Pamela Qirko, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

- 1.** Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në nenin 179/b, paragrafi 5 i ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe, në nenin 3, pika 5 dhe nenin 5, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- 2.** Subjekti i rivlerësimit, z. Taulant Banushi, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, është subjekt që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
- 3.** Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), më 16.12.2019 zhvilloi procedurat e shortit të shpërndarjes së çështjeve në trupa gjykues, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Taulant Banushi, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Etleda Çiftja, Pamela Qirko dhe Roland Ilija. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionere Pamela Qirko.
- 4.** Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 20.12.2019 u caktua me mirëkuptim kryesues z. Roland Ilija, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.
- 5.** Referuar pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
- 6.** Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
- 7.** Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.
- 8.** Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016 dhe në legjislationin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.
- 9.** Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ).
- 10.** Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Taulant Banushi, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016. Në

¹ Akti i përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë me nr. *** prot., datë 6.2.2018.

përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit është konstatuar se:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

11. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportet e mbajtura për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

12. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport² të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe me provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 9.3.2022, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

15. Subjekti i rivlerësimit, në datën 10.3.2022, u njoftua mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 11.3.2022, si dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve në datën 18.3.2022, në rrugë elektronike, me *e-mail*.

16. Pas shqyrtimit të shpjegimeve të vëna në dispozicion, trupi gjykues, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, me *e-mail*, në datën 23.3.2022. Gjithashtu, në datën 23.3.2022, subjekti i rivlerësimit depozitoi edhe fizikisht në Komision prapësimet e tij të shoqëruara me prova mbështetëse³.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në datën 28.3.2022, ora 13:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati Kongreseve), salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi.

² Raporti për analizimin e aftësive profesionale me nr. *** prot., datë 7.9.2021.

³ Shpjegimet dhe provat e depozituara, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 23.3.2022.

18. Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

19. Zoti Taulant Banushi ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

19.1. Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

20. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

20.1. Ligji nr. 84/2016 ka përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, si dhe të proporcionalitetit, parime këto që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor. Në këtë ligj përcaktohet angazhimi i organeve kompetente ndihmëse në procesin e rivlerësimit që kryhet nga Komisioni.

20.2. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

20.3. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

20.4. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse për kryerjen e vlerësimit profesional.

20.5. Por, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017⁴ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

20.6. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja bashkë me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin

⁴ “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

kalimtar, “Vetting”, deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite, si dhe aktet mbështetëse si dokumentacion bashkëlidhur raportit; b) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; c) raportin e kontrollit të figurës, të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; ç) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja; d) denoncimet e publikut; e) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit, si dhe nëpërmjet postës elektronike për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

21. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti dhe ligjshmërisë së burimit dhe të krijimit të saj.

21.1. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, të paraqitur më parë në ILDKPKI, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion, i cili pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit.

21.2. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, si edhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive. Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI më 26.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar këto pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme:

22. Pasuria e llojit “apartament banimi”, me sipërfaqe 108.12 m², ndodhur në Fier, blerë me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.12.2015, me vlerë 5,000,000 lekë.

22.1. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar të ardhurat e krijuara në vitet 2012 dhe 2013 nga puna e tij dhe e bashkëshortes.

Deklarimi i kësaj pasurie në vite

23. Në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë të vitit 2012 (këtej e në vijim DIP), subjekti ka deklaruar se ka paguar një pjesë të kontratës me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.11.2012, për blerje apartament banimi, shumën prej 2,200,000 lekë. Si burim për kryerjen e kësaj pagese ka deklaruar të ardhurat e realizuara gjatë vitit, të përshkruara në faqen 4 të deklaratës.

23.1. Në seksionin “*Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private*” të kësaj deklarate (që i përket faqes 4 të formularit) ka deklaruar: (a) të ardhura nga paga si gjyqtar në shumën 954,808 lekë; (b) të ardhura nga aktiviteti privat i bashkëshortes (farmaci “****”) në shumën 1,990,669 lekë, për të cilat shpjegon se janë referuar me përafërsi, pasi ende nuk ishte mbyllur bilanci; (c) të ardhurat e bashkëshortes, përfutur nga sigurimet shoqërore, për efekt të lejes së lindjes, në shumën 112,900 lekë; (d) të ardhurat nga interesat bankarë në “Intesa SanPaolo Bank”, shumën 112,032 lekë; dhe (e) të ardhurat nga interesat bankarë në “Union Bank”, shumën 134,229 lekë.

23.2. Pra, rezulton se për vitin 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura neto të përfutura prej tij dhe personit të lidhur (bashkëshortes), në total shumën 3,304,638 lekë.

23.3. Në DIP/2013, subjekti ka deklaruar se ka paguar pjesën e mbetur të kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.11.2012, për blerjen e një apartamenti banimi, në shumën 2,800,000 lekë. Si burim për kryerjen e kësaj pagese ka deklaruar të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2013, të përshkruara në faqen 4.

23.4. Në seksionin “*Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private*” të kësaj deklarate (që i përket faqes 4 të formularit) ka deklaruar: (a) të ardhura nga paga si gjyqtar, në shumën 966,856 lekë; (b) të ardhura nga paga si pedagog i jashtëm në universitetin “****”, dega Fier, në shumën 237,150 lekë; (c) të ardhura nga aktiviteti privat i bashkëshortes (farmaci “****”),

në shumën 2,190,600 lekë; (d) të ardhurat nga paga e bashkëshortes si punonjëse në aktivitetin privat, në shumën 367,200 lekë; (d) të ardhurat nga interesat bankarë në “Intesa SanPaolo Bank”, në shumën 111,728 lekë; dhe (e) të ardhura nga interesat bankarë në “Union Bank”, në shumën 108,030 lekë.

23.5. Pra, rezulton se për vitin 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura neto të përfituara prej tij dhe personit të lidhur, në total shumën 3,981,564 lekë.

Konkluzionet e ILDKPKI-së për këtë pasuri

24. Është i paqartë fakti i aplikimit për kredi të subjektit në BKT, për pagesën e këstit të dytë të apartamentit në shumën 2,800,000 lekë, sipas kontratës për shitje sendi në të ardhmen, datë 17.11.2012, pasi, sipas deklaramit të interesave privatë periodikë vjetorë 2013, pagesa rezulton të jetë bërë nga të ardhurat vjetore familjare.

24.1. Është i panjohur vendbanimi i subjektit gjatë periudhës 2013 - 2015, pasi nuk ka deklaruar adresa banimi në deklaramit e interesave privatë periodikë vjetorë përkatës (apartamenti i përfutur nga privatizimi është shitur në datën 8.3.2013).

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni për këtë pasuri

25. Nga verifikimi dokumentacionit të dërguar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Fier⁵, pjesë e dosjes së dërguar nga ILDKPKI-ja, dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit, me dorëzimin e deklaramit “Vetting”, si edhe dokumentacionit të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ për këtë pasuri, konstatohet se:

25.1. Në datën 17.11.2012, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e palës blerëse të ardhshme dhe shoqëria “****” sh.p.k., në cilësinë e palës shitëse të ardhshme, kanë lidhur kontratën e shitjes së një sendi në të ardhmen⁶, me objekt pasurinë e llojit “apartament banimi”, me sipërfaqe 130.1 m², ndodhur në lagjen “****”, Fier, për çmimin 5,000,000 lekë.

25.2. Ndërsa, plani i pagesave është përcaktuar si vijon: (i) kësti i parë në shumën 2,200,000 lekë është paguar në datën e lidhjes së kontratës, jashtë zyrës noteriale; dhe (ii) kësti i dytë në shumën 2,800,000 lekë do paguhej me lëvrimin e kredisë bankare për të cilën pala blerëse kishte aplikuar pranë BKT-së, dega Fier.

25.3. Për pagesën e këstit të parë është lëshuar nga shoqëria mandatpagesa e datës 17.11.2012, me përshkrimin “*Taulant Banushi, pagesë për blerje apartamenti*”.

25.4. Komisioni konstaton se në DIP/2012 subjekti nuk ka deklaruar detyrimin financiar të mbetur ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., në seksionin përkatës ku deklarohen detyrimet.

25.5. Në datën 17.3.2014, shoqëria “****”, nëpërmjet përfaqësuesit ligjor të saj, z. A.H, ka nënshkruar një dokument noterial⁷, nëpërmjet të cilit ka deklaruar se në muajin dhjetor të vitit 2013 i është shlyer pjesa e mbetur e çmimit të dakordësuar për blerjen e apartamentit objekt vlerësimi, në vlerën 2,800,000 lekë, dhe se palët janë shlyer plotësisht me njëra – tjetrën, duke mos pasur më detyrime financiare.

25.6. Për pagesën e këstit të dytë në shumën 2,800,000 lekë është lëshuar nga shoqëria mandatpagesa e datës 20.12.2013, me përshkrimin “*Taulant Banushi, likuidim detyrimi për blerje apartamenti*”.

25.7. Siç u konstatua më sipër, në kontratën e datës 17.11.2012, të lidhur mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “****” sh.p.k., parashikohej që kësti i dytë në shumën prej 2,800,000 lekë do paguhej me lëvrimin e kredisë bankare që pala blerëse kishte aplikuar pranë BKT-së, dega Fier, por, nga

⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 18.9.2017.

⁶ Kontratë shitjeje e një sendi në të ardhmen me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.11.2012, redaktuar nga noteri publik, znj. F.Z.

⁷ Deklarata noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.3.2014, redaktuar nga noteri publik, znj. F.Z.

hetimi i kryer nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit dhe/apo personi i lidhur të ketë/kenë përfituar kredi në këtë bankë.

25.8. Nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit ka vetëdeklaruar se kjo pagesë është kryer me të ardhurat e vitit 2013. Si rrjedhim, në analizën financiare do të reflektohen se kanë shërbyer si burim krijimi i pagesës së çmimit të kështit të dytë për pasurinë, të ardhurat e krijuara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur përgjatë vitit 2013.

25.9. Në datën 29.12.2015 është nënshkruar mes palëve kontrata e shitblerjes⁸ së kësaj pasurie, për çmimin 5,000,000 lekë. Në këtë kontratë është cituar se çmimi total është likuiduar si vijon: (i) shuma 2,200,000 lekë është paguar sipas kontratës për shitje sendi në të ardhmen nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.11.2012; dhe (ii) shuma 2,800,000 lekë është paguar në datën 20.12.2013, duke referuar edhe 2 (dy) mandatpagesat përkatëse dhe deklaratën noteriale të lëshuar nga shoqëria, të konstatuara si më sipër.

25.10. Ky apartament banimi figuron të jetë i regjistruar në regjistrat hipotekorë në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, me nr. pasurie ***, vol ***, faqe ***, ndodhur në zona kadastrale ***, me adresë: lagjja “****”, Fier, me sipërfaqe prej 108,12 m² dhe sipërfaqe të ambienteve të përbashkëta 13,52 m².

25.11. Sa më sipër, Komisioni konstaton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me pasurinë objekt vlerësimi, apartamentin e banimit të ndodhur në Fier.

25.12. Në vijim, nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të depozituara nga subjekti në ILDKPKI rezultoi se për vitet 2014 dhe 2015 ai nuk ka deklaruar adresë banimi.

Pasi Komisioni i kërkoi⁹ të deklarojë mbi vendbanimet e tij përgjatë periudhës që ka ushtruar detyrën, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *nga muaji gusht 2004 deri në muajin nëntor 2013 ka jetuar në pjesën e tij të apartamentit që ka pasur në bashkëpronësi me prindërit, i ndodhur në Fier, të cilin e kanë fituar në bazë të ligjit “Për privatizimin e banesave shtetërore”. Ndërsa, nga muaji nëntor 2013 e në vazhdim jeton në apartamentin të cilin e ka në pronësi me bashkëshorten, në Fier.*

25.13. Por, nga verifikimi i akteve të administruara në dosje rezulton se apartamenti, i cili ka qenë në bashkëpronësi me prindërit, është shitur në datën 8.3.2013.

25.14. Në këto kushte, Komisioni i kërkoi¹⁰ subjektit të deklarojë mbi vendbanimin e tij për periudhën nga shitja e apartamentit të përfituar më parë në bazë të ligjit të privatizimit, data 8.3.2013, deri në muajin nëntor të këtij viti (deklaruar më parë se në këtë muaj ka hyrë në banesën e re). Në përgjigje të pyetjes së Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se *në periudhën nga muaji mars i vitit 2013 deri në muajin nëntor të vitit 2013 ka vazhduar të banojë në pjesën e tij të apartamentit, të cilin e ka patur në bashkëpronësi me prindërit, pasi megjithëse në muajin mars të vitit 2013, këtë apartament ia kanë shitur shtetasit M.C, i kanë vënë si kusht se apartamenti do të lirohej në muajin nëntor të vitit 2013, kusht i cili u pranua nga blerësi. Kushti i vendosur prej tij ka qenë i diktuar nga vështirësia që brenda një kohe të shkurtër, të mund të gjenin dhe të zhvendoseshin në një banesë me qira, duke qenë se apartamenti i ri do të përfundonte brenda disa muajve. Në mbështetje të deklarimeve të tij, subjekti ka depozituar deklaratën¹¹ e datës 13.11.2021, të nënshkruar nga shtetasi M.C. Në lidhje me mosdeklarimin e adresës së banimit në DIP/2014 dhe 2015, subjekti ka shpjeguar se kjo ka ndodhur për shkak pakujdesie gjatë plotësimit të tyre, duke konfirmuar se në këtë periudhë adresa e tij e banimit ka qenë: “Fier, lagjja “****”, rruga “****”.*

⁸ Kontratë shitblerjeje e pasurisë së paluajtshme me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.12.2015, redaktuar nga noteri publik, znj. F.Z.

⁹ Pyetësi nr. 1.

¹⁰ Pyetësi nr. 2.

¹¹ Deklaratë noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.11.2021, redaktuar nga noteri publik, znj. R. H.

Analiza e të ardhurave të deklaruara si burim krijimi i kësaj pasurie

26. Sikurse u konstatua më sipër, nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë të viteve 2012 dhe 2013 (të depozituara nga subjekti në ILDKPKI) konstatohet se si burime krijimi të pasurisë objekt vlerësimi, të cilat kanë shërbyer për pagesat e kryera në datën 17.11.2012 dhe datë 20.12.2013, për likuidimin e çmimit të saj, janë deklaruar: (i) të ardhurat nga paga e subjektit si gjyqtar; (ii) të ardhurat nga paga/honoraret e subjektit si pedagog i jashtëm në universitetin “****”; (iii) të ardhurat nga aktiviteti privat i bashkëshortes; (iv) të ardhurat nga paga e bashkëshortes në të njëjtin aktivitet; (v) të ardhurat e bashkëshortes për efekt të lejes së lindjes; (vi) të ardhurat nga interesat bankarë, nga depozitat në “Intesa SanPaolo Bank” dhe “Union Bank”.

Të ardhurat nga paga e subjektit si gjyqtar

26.1. Referuar dokumentacionit justifikues ligjor të administruar në dosje, rezulton se paga e kredituar në llogarinë bankare të subjektit nga ushtrimi i detyrës së gjyqtarit, për vitin 2012, ka qenë në shumën 961,925 lekë dhe për vitin 2013 ka qenë në shumën prej 964,590 lekësh.

Në analizën financiare do të pasqyrohen të ardhurat vjetore nga pagat, të cilat janë kredituar dhe tërhequr deri në datën e pagesës së secilit këst, sipas vitit përkatës.

Të ardhurat nga paga e subjektit si pedagog

26.2. Nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë periodikë vjetorë të depozituar nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, konstatohet se për vitet 2007, 2008, 2009, 2010, 2011 dhe 2013 ka deklaruar të ardhura nga paga si pedagog i jashtëm në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti “****”, dega Fier, duke evidentuar edhe bankën përkatëse dhe numrin e llogarisë ku janë kredituar këto shuma.

26.3. Komisioni verifikoi specifikisht të ardhurat e deklaruara si të përfituara nga puna si pedagog i jashtëm në këtë universitet, që i përkasin vitit 2013, si të ardhurat e vetme të përfituara nga ky burim, të cilat mund të kenë shërbyer për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi. Rezulton se në DIP/2013, subjekti ka deklaruar se ka përfituar të ardhura nga paga prej punës së tij si pedagog i jashtëm, në total shumën prej 237,150 lekësh.

26.4. Referuar dokumentacionit të dërguar nga “Union Bank”¹² konstatohet se përgjatë vitit 2013 në llogarinë e subjektit të rivlerësimit është kredituar në total shuma prej 237,150 lekësh, e konkretisht: (1) në datën 5.2.2013, shuma 64,800 lekë me përshkrimin “*Honorare S.I Drejtësi dhe Shkenca Sociale Fier 2011-2012*”; (2) në datën 23.9.2013, shuma prej 86,400 lekësh me përshkrimin “*Honorare S.II 2011-2012, Fier, Drejtësi*”; dhe (3) në datën 8.11.2013 shuma prej 85,950 lekësh me përshkrimin “*Honorare Drejtësi 2012-2013 S.I, Fier*”.

26.5. Komisioni konstaton se totali i vlerave të kredituara në llogarinë e subjektit në “Union Bank” përgjatë vitit 2013, në dukje të ardhura nga puna e tij në Universitetin “****” – dega Fier, përputhet me shumën e deklaruar nga subjekti në DIP/2013. Nga ana tjetër rezulton se të gjitha këto vlera monetare janë tërhequr para datës së kryerjes të pagesës së këstit të dytë.

26.6. Në vijim, pasi u evidentuan të gjitha kreditimet e kryera në llogarinë e subjektit të rivlerësimit, nga përshkrimi në dukje si kreditime page nga puna e tij si pedagog, Komisioni i kërkoi¹³ “Union Bank” të konfirmojë se cila është pala kredituese, e cila ka kryer këto transferta. “Union Bank”¹⁴ konfirmon se kreditimet e kryera në llogarinë rrjedhëse të subjektit të rivlerësimit, pagamarrësi me ref. ***, për periudhën 28.12.2007 deri 8.11.2013, janë kreditime page nga subjekti “****” sh.p.k.

¹² Shkresa e “Union Bank” me nr. *** prot., datë 13.5.2020, protokolluar me nr. *** prot., datë 14.5.2020.

¹³ Shkresa nr. *** prot., datë 19.1.2022.

¹⁴ Shkresa e Union Bank nr. *** prot., datë 8.2.2022, protokolluar me nr. *** prot., datë 10.2.2022.

Të ardhurat nga paga dhe fitimi i realizuar prej aktivitetit privat të bashkëshortes

27. QKB-ja¹⁵, informon se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. O.B, figuron e regjistruar si person fizik, me NIPT ***. Nga verifikimi i ekstraktit historik të regjistrimit tregtar rezulton se ky tatimpagues është regjistruar në datën 8.12.2004, me objekt të veprimtarisë në fushën e farmacisë, mban emrin tregtar “****” dhe ka si adresë të zhvillimit të aktivitetit në Patos, lagjja “****”, rruga “****”, pallati ***, kati ***, njësia ***, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve¹⁶ konfirmon se ky subjekt figuron me me status “çregjistruar” që në datën 28.12.2018.

27.1. Në vijim të verifikimit dhe analizimit të të dhënave mbi qarkullimin dhe fitimin neto të realizuar për çdo vit ushtrimor nga ky tatimpagues, bazuar në dokumentacionin ligjor të administruar në dosje¹⁷ rezultoi se për vitin 2005 qarkullimi i realizuar ka qenë në vlerën 21,742,690 lekë, për të cilin janë paguar detyrime tatimore (tatim fitimi i thjeshtuar) në shumën 616,539 lekë, ndërsa të dhënat për vitet 2006 – 2016, lidhur me qarkullimin, fitimin bruto, tatimin e paguar dhe fitimin neto pas pagesës së tatimit, paraqiten për çdo vit sipas tabelës së mëposhtme:

Tatimpaguesi	"O.B person fizik, me Nipt *** me emër tregtar Farmaci ****"										
Viti	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Qarkullimi	10,616,389	15,855,376	17,834,582	13,665,616	12,012,238	23,677,336	23,454,348	17,871,502	20,730,074	21,644,217	29,336,867
Fitimi bruto/para tatimit	1,412,892	1,083,385	1,438,699	824,600	610,568	1,300,496	2,235,762	2,434,000	3,275,677	3,163,642	2,330,223
Tatimi i paguar	282,578	216,677	143,870	82,460	61,057	130,050	223,576	243,400	491,352	474,546	513,958
Fitimi neto pas tatimi	1,130,314	866,708	1,294,829	742,140	549,511	1,170,446	2,012,186	2,190,600	2,784,325	2,689,096	1,980,690

27.2. Sa më sipër rezulton se për vitin 2012 (vit në të cilin është kryer pagesa e këstit të parë për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi) të ardhurat neto që janë përfituar prej bashkëshortes së subjektit nga zhvillimi i aktivitetit tregtar janë në shumën 2,012,186 lekë, ndërsa për vitin 2013 (vit në të cilin është kryer pagesa e këstit të dytë të pasurisë objekt vlerësimi) janë në shumën prej 2,190,600 lekë.

27.3. Komisioni ka përllogaritur në mënyrë alternative të ardhurat e mundshme të përfituara nga zhvillimi i aktivitetit tregtar për vitin 2012 – deri në datën 17.11.2012 (data e pagesës së këstit të parë) dhe për vitin 2013 – deri në datë 20.12.2013 (data e pagesës së këstit të dytë). Pasi u pjesëtua shuma totale e fitimit neto të realizuar me ditët kalendarike të një viti, doli vlera e cila përkon me mesataren e fitimit për një ditë kalendarike. Për vitin 2012 rezulton se pagesa e këstit është kryer 44 ditë para mbylljes së tij, ndërsa për vitin 2013 rezulton se pagesa e këstit është kryer 12 ditë para mbylljes së tij.

27.4. Në vijim të përllogaritjeve të bëra për vitin 2012, rezulton se për 44 ditë kalendarike i takon fitimi neto prej 242,000 lekësh, ndërsa për vitin 2013, për 12 ditë kalendarike, i takon fitimi neto prej 72,019 lekësh. Në analizën financiare, e cila do kryhet në datat e pagesave të kësteve, do të zbriten këto vlera në të ardhurat që do të reflektohen nga fitimi neto i aktivitetit tregtar të bashkëshortes së subjektit. Gjithsesi, vlen të theksohet se kjo është një analizë me rezervë, për sa kohë nuk rezulton që për këto dy vite tatim fitimi të jetë parapaguar dhe për më tepër nuk mund të bëhet një përllogaritje e saktë dhe objektive e të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara nga

¹⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 15.5.2020, protokolluar me nr. *** prot., datë 19.5.2020.

¹⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 12.5.2020, protokolluar me nr. *** prot., datë 14.5.2020.

¹⁷ Shkresa e DPT-së me nr. *** prot., datë 12.5.2020, protokolluar me nr. *** prot., datë 14.5.2020; shkresa e DRT-së Fier me nr. *** prot., datë 17.10.2016, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së, aneks ***; shkresa e DRT-së Fier me nr. *** prot., datë 11.07.2017, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së, aneks ***; shkresa e DRT-së Fier me nr. *** prot., datë 24.8.2017, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së, aneks ***; shkresa e DRT-së Fier me nr. *** prot., datë 13.1.2020, depozituar nga subjekti bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 1, të dërguar nga Komisioni; shkresa e DRT-së Fier me nr. *** prot., datë 2.2.2022, protokolluar me nr. *** prot., datë 3.2.2022; deklarimet e bëra nga subjekti ndër vite, sipas deklaratave të interesave privatë periodikë vjetorë, të depozituar në ILDKPKI.

subjekti tregtar deri në datat e kryerjes së pagesave, sipas kësteve, për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi.

27.5. Në vijim, Komisioni, me qëllim verifikimin e mundësisë së fitimit neto nga aktiviteti tregtar i bashkëshortes së subjektit për vitin 2005, në kushtet kur referuar legjislacionit fiskal të kohës është paguar tatim mbi qarkullimin dhe jo mbi fitimin, konstatoi se në vitet pasardhëse fitimi neto i këtij subjekti tregtar ka qenë rreth 8% e qarkullimit, për rrjedhojë u vlerësua se edhe për vitin 2005 fitimi neto ka qenë 8% e qarkullimit, që i përket vlerës prej 1,739,415 lekësh.

27.6. Gjithashtu nga të dhënat e ISSH-së¹⁸ mbi deklarin e pagave të bashkëshortes, rezulton se për vitin 2012, pas pagesës së kontributeve të sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore dhe tatimit mbi të ardhurat, totali i të ardhurave neto të përfituara ka qenë në shumën 190,266 lekë, ndërsa për vitin 2013 ka qenë në vlerën prej 368,788 lekësh.

27.7. Komisioni konstatoi se pagat e bashkëshortes së subjektit për këtë periudhë janë kredituar në llogarinë e saj në “Tirana Bank”¹⁹. Në analizën financiare do të pasqyrohen të ardhurat vjetore nga pagat të cilat janë kredituar dhe tërhequr deri në ditën e pagesës së secilit këst, sipas vitit përkatës.

Të ardhurat e bashkëshortes, zonjës O.B, për efekt të lejes së lindjes

28. Referuar vërtetimit të lëshuar nga DRSSH-ja Fier²⁰ rezulton se bashkëshortja e subjektit është paguar për lindjen e fëmijës së dytë nga data 9.5.2011 deri në datën 8.5.2012, në shumën prej 138,215 lekësh. Në vijim, nga verifikimi dhe analizimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit në mbështetje të deklarimeve të tij të bëra në ILDKPKI²¹ sipas “*Procesverbalit mbi deklarin e subjektit të deklarin të pasurive*”, të datës 7.10.2014, konstatohet se referuar vërtetimit të DRSSH Fier²², të datës 28.3.2013, znj. O.B, ka përfituar të ardhura neto nga leja e lindjes për vitin 2012, në total shumën prej 112,943 lekësh (shumë e cila përkon me deklarin e bërë në DIP/2012).

Të ardhurat nga interesat bankarë

29. Nga verifikimi dhe analizimi i dokumentacionit bankar të administruar në dosje²³ rezulton se subjekti ka përfituar të ardhura nga interesat bankarë: i) për vitin 2012, në total shumën prej 246,161 lekë, nga të cilat vlerën prej 112,032 lekë nga depozitat në “Intesa SanPaolo Bank” dhe vlerën prej 134,129 lekësh nga depozitat në “Union Bank”; ii) për vitin 2013, në total shumën prej 243,092 lekësh, nga të cilat vlerën 111,727 lekë nga depozitat në “Intesa SanPaolo Bank” dhe vlerën 131,365 lekë nga depozitat në “Union Bank”.

29.1. Gjithashtu, rezulton se të ardhurat e përfituara nga interesat bankarë për vitin 2012 janë tërhequr plotësisht përpara datës së pagesës së këstit të parë për pasurinë objekt vlerësimi. Ndërsa, për vitin 2013, deri në datën e pagesës së këstit të dytë, janë tërhequr në total të ardhura të përfituara nga interesat bankarë në shumën prej 208,954 lekësh (shumë e cila do reflektohet në analizën financiare për mundësinë e pagesës së këstit të dytë).

29.2. Bazuar në vetëdeklarimet e bëra, si edhe dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, me qëllim verifikimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për kryerjen e pagesave për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2012 – 17.11.2012 (data e pagesës së këstit

¹⁸ Shkresa nr. *** prot., datë 7.5.2020, protokolluar me nr. *** prot., datë 8.5.2020.

¹⁹ Shkresa e “Tirana Bank” me nr. *** prot., datë 6.5.2020, protokolluar me nr. *** prot., datë 11.5.2020.

²⁰ Vërtetimi i DRSSH-së Fier me nr. *** prot., datë 14.10.2016, depozituar nga subjekti me dorëzimin e deklaratës “Vetting”, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së, aneks ***.

²¹ Dokumentacioni i përcjellë me shkresën e ILDKPKI-së me nr. *** prot., datë 18.1.2022, protokolluar me nr. *** prot., datë 18.1.2022.

²² Vërtetimi i DRSSH-së Fier me nr. *** prot., datë 28.3.2013.

²³ Shkresa e “Intesa SanPaolo Bank” me nr. *** prot., datë 12.05.2020, protokolluar me nr. *** prot., datë 18.5.2020 dhe shkresa e “Union Bank” me nr. *** prot., datë 13.5.2020, protokolluar me nr. *** prot., datë 14.5.2020.

të parë) dhe për periudhën 1.1.2013 – 20.12.2013 (data e pagesës së këstit të dytë), të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 1.

<i>Analiza financiare për verifikimin mundësisë e likuidimit të çmimit të blerjes së apartamentit, kryer në datat e pagesave të kësteve (Vlerat në lekë)</i>	1.1.2012 - 17.11.2012	1.1.2013 - 20.12.2013
A) Pasuri	5 062 846	1 500 723
Apartament banimi në Fier, blerë në datën 29.12.2015 (çmimi 5,000,000 lekë).	5 000 000	
Ndryshim likuiditeti	62 846	1 500 723
B) Detyrime	2 800 000	0
Detyrim i mbetur shoqërisë së ndërtimit	2 800 000	
C) Pasuri neto (A-B)	2 262 846	1 500 723
D) Të ardhura	3 128 996	5 396 564
Të ardhura nga paga ushtrimi i detyrës, subjekti i rivlerësimit	871 858	964 590
Të ardhura nga paga si pedagog Universiteti “***”, subjekti i rivlerësimit	-	237 150
Të ardhura nga ushtrimi i aktivitetit, farmaci “***”, (bashkëshortja)	1 769 621	2 118 580
Të ardhura nga paga, ushtrimi i aktivitetit farmaci “***”, (bashkëshortja)	128 456	367 290
Të ardhura nga ISSH-ja, bashkëshortja e subjektit	112 900	
Të ardhura nga interesat bankarë të depozitave me afat	246 161	208 954
Të ardhura nga shitja e apartamentit në Fier (përfituar 1/3 e vlerës)		1 500 000
E) Shpenzime	662 645	3 713 926
Shpenzime jetike	496 095	564 096
Shpenzime për pagesën e këstit të dytë ndaj shoqërisë së ndërtimit 20.12.2013		2 800 000
Shpenzime për mobilim		200 000
Shpenzime për shkollimin e fëmijëve	166 550	149 830
Balanca e fondeve (D-C-E)	203 505	181 915

29.3. Sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur (bashkëshortja) kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht kryerjen e pagesave për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi.

Pasuritë e llojit “likuiditete” - depozitat bankare

30. Depozitat bankare në “Intesa SanPaolo Bank” (i) depozita e krijuar në datën 30.12.2005, me vlerë 500,000 lekë; (ii) depozitë e krijuar në datën 28.7.2006, me vlerë 600,000 lekë; dhe (iii) depozitë e krijuar në datën 12.12.2006, me vlerë 1,000,000 lekë.

30.1. Si burim krijimi të këtyre pasurive ka deklaruar të ardhurat nga puna, të përfituara prej tij dhe bashkëshortes.

Deklarimi i këtyre pasurive në vite

31. Në DIP/2005, subjekti ka deklaruar llogarinë bankare “depozitë” në Bankën Amerikane (sot “Intesa SanPaolo Bank”), shumën prej 500,000 lekësh.

31.1. Në DIP/2006, subjekti ka deklaruar 2 (dy) llogari bankare “depozitë” në Bankën Amerikane (sot “Intesa SanPaolo Bank”), njëra në shumën 600,000 lekë dhe tjetra në shumën 1,000,000 lekë.

32. Konstatimi i ILDKPKI-së për këto pasuri: është i dyshimtë krijimi i depozitës 1,000,000 lekë në vitin 2006, me burim kursimet familjare për periudhën.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni për këto pasuri

33. Referuar informacionit të dërguar nga “Intesa SanPaolo Bank”²⁴ (ish - Banka Amerikane), rezulton se në datën 1.3.2005, në këtë bankë është hapur llogaria e subjektit të rivlerësimit në monedhën lek (me numër bazë ***). Nga verifikimi i lëvizjeve të kësaj llogarie konstatohet se duke filluar prej datës 1.3.2005, në këtë llogari ka filluar të kreditohet paga e subjektit të rivlerësimit nga puna e tij si gjyqtar. Si rrjedhojë e akumulimit të një pjese të të ardhurave nga paga të patërhequra (në shumën prej 380,000 lekë) dhe depozitimit *cash* nga ana e subjektit të shumës prej 120,000 lekë²⁵ në këtë llogari, në datën 30.12.2015, shuma prej 500,000 lekësh është investuar në depozitë me afat.

33.1. Në vijim të verifikimit të lëvizjeve të kësaj llogarie rezulton se: (i) në datën 28.7.2006, subjekti ka depozituar *cash* shumën prej 600,000 lekësh, duke e investuar në depozitë me afat 1-vjeçar; dhe (ii) në datën 12.12.2006 subjekti ka depozituar *cash* shumën prej 1,000,000 lekësh, të cilën e ka investuar në depozitë me afat 1-vjeçar.

33.2. Këto 3 (tri) depozita të krijuara nga subjekti i rivlerësimit në “Intesa SanPaolo Bank” në vitet 2005 dhe 2006, me vlera fillestare 500,000 lekë, 600,000 lekë dhe 1,000,000 lekë, janë investuar sërish gjatë gjithë periudhës për vitet 2006 – 2016, por konstatohet se të ardhurat nga interesat bankarë, të përfituar gjatë viteve, janë tërhequr periodikisht nga subjekti i rivlerësimit, sipas maturimit të tyre.

33.3. Pra, rezulton se në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” subjekti i rivlerësimit ka patur 3 (tri) llogari bankare “depozitë” në këtë bankë, sipas vlerave fillestare të krijimit të tyre në total shumën prej 2,100,000 lekësh.

33.4. Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me gjendjen e llogarive “depozitë”, në “Intesa SanPaolo Bank”.

34. Depozitat bankare në “Union Bank”: (i) depozita e krijuar në datën 8.7.2008, me vlerë 500,000 lekë; (ii) depozita e krijuar në datën 5.8.2009, me vlerë 1,000,000 lekë; dhe (iii) depozita në datën 27.8.2010 (*evidentuar si e krijuar në vitin 2008*)²⁶, me vlerë 500,000 lekë.

34.1. Si burim krijimi të këtyre pasurive ka deklaruar të ardhurat nga puna, të përfituara prej tij dhe bashkëshortes.

Deklarimi i këtyre pasurive në vite

35. Në DIP/2008, subjekti ka deklaruar krijimin e 2 (dy) llogarive bankare “depozitë” në “Union Bank”, secila me vlerë 500,000 lekë.

35.1. Në DIP/2009, subjekti ka deklaruar krijimin e llogarisë bankare “depozitë” në “Union Bank”, në vlerën 1,000,000 lekë.

36. Konstatimi i ILDKPKI-së për këto pasuri: është i dyshimtë krijimi i depozitës 1,000,000 lekë në vitin 2009, me burim kursimet familjare për periudhën.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni për këto pasuri

37. Referuar informacionit të dërguar nga “Union Bank”²⁷ rezulton se në datën 17.12.2007, subjekti ka hapur llogari page në këtë bankë. Nga verifikimi i lëvizjeve të kësaj llogarie rezulton se duke filluar nga data 18.12.2007 subjekti ka filluar t’i kreditohet paga/honoraret nga puna si pedagog në

²⁴ Shkresa e ISP Bank me nr. *** prot., datë 12.5.2020, protokolluar me nr. *** prot., datë 18.5.2020.

²⁵ Shumë e depozituar nga subjekti në datën 30.12.2005.

²⁶ Depozitë e krijuar në datën 3.7.2008 (deklaruar edhe vetë nga subjekti në DIP/2008). Ndërsa, konstatohet se data e referuar nga subjekti i rivlerësimit përkon me datën e riinvestimit të kësaj depozite.

²⁷ Shkresa e “Union Bank” me nr. *** prot., datë 13.5.2020, protokolluar me nr. *** prot., datë 14.5.2020.

Universitetin “****”. Si rrjedhojë e akumulimit të pagave të patërhequra, në datën 3.7.2008 është akumuluar shuma prej 500,000 lekësh, e cila është investuar në depozitë me afat.

37.1. Në vijim të verifikimit të lëvizjeve të kësaj llogarie rezulton se: (i) në datën 8.7.2008, subjekti ka depozituar *cash* shumën prej 500,000 lekësh, duke e investuar në depozitë me afat 1-vjeçar; dhe (ii) në datën 5.8.2009, subjekti ka depozituar *cash* shumën prej 400,000 lekësh, e cila së bashku me pagat/honoraret e patërhequra nga kjo llogari në shumën 600,000 lekë (krijuar gjatë vitit 2008 dhe 2009), është investuar në depozitë me afat, në total shuma prej 1,000,000 lekësh.

37.2. Këto 3 (tri) depozita, të krijuara nga subjekti i rivlerësimit në “Union Bank” në vitet 2008 dhe 2009, janë investuar sërish përgjatë gjithë periudhës nga viti 2008 – 2016, por konstatohet se të ardhurat nga interesat bankarë, të përfituar gjatë viteve, janë tërhequr periodikisht nga subjektit i rivlerësimit, sipas maturimit të tyre.

37.3. Pra, rezulton se në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” subjekti i rivlerësimit ka pasur 3 (tri) llogari bankare “depozitë” në “Union Bank”, sipas vlerave fillestare të krijimit të tyre, në total shumën prej 2,000,000 lekësh.

37.4. Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me gjendjen e llogarive “depozitë”, në “Union Bank”.

Analiza e të ardhurave të deklaruara si burim krijimi i pasurive të llojit “depozita bankare”, në “Intesa SanPaolo Bank” dhe “Union Bank”. Verifikimi i mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për krijimin e tyre

38. Referuar deklaramëve të bëra rezulton se si burim krijimi i depozitave të sipërcituara të kenë shërbyer: (i) të ardhurat nga paga e subjektit si gjyqtar; (ii) të ardhurat nga paga/honoraret e subjektit si pedagog i jashtëm në Universtitetin “****”; (iii) të ardhurat nga aktiviteti privat i bashkëshortes dhe të ardhurat nga paga e përfituar, si rrjedhojë e punësimit në të njëjtit aktivitet.

38.1. Bazuar në vetëdeklarimet e bëra, si edhe dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, pasi u verifikuan të ardhurat e referuara nga këto burime, por edhe nga burime të tjera sipas viteve përkatëse, të cilat janë evidentuar/kredituar dhe përfituar/tërhequr gjatë vitit kalendarik deri në ditën e kryerjes së investimit për secilën depozitë, Komisioni kreu analizat e treguesve financiarë, me qëllim verifikimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për krijimin e këtyre pasurive të llojit “depozitë”, të pasqyruar në tabelat si më poshtë:

Tabela nr. 2.

<i>Analiza financiare për verifikimin mundësisë për investimin e kryer në datën 30.12.2005, për krijimin e depozitës në shumën prej 500,000 lekë në “ISP Bank” (Vlerat në lekë)</i>	Viti 2005
A) Pasuri	2 001 144
Ndryshim likuiditeti	2 001 144
B) Detyrime	0
C) Pasuri neto (A-B)	2 001 144
D) Të ardhura	2 795 821
Të ardhura nga paga ushtrimi i detyrës, subjekti i rivlerësimit	786 406
Të ardhura nga ushtrimi i aktivitetit tregtar, farmaci “****” (bashkëshortja e subjektit)	1 739 415
Të ardhura nga ISSH-ja, bashkëshortja subjektit	70 000
Të ardhura nga shitja e automjetit të markës “****”	200 000
E) Shpenzime	303 758
Shpenzime jetike	303 758
Balanca e fondeve (D-C-E)	490 919

Tabela nr. 3.

<i>Analiza financiare për verifikimin mundësisë për investimin e kryer në datën 28.7.2006, për krijimin e depozitës në shumën prej 500,000 lekësh në "ISP Bank" (Vlerat në lekë)</i>	1.1.2006- 28.7.2006
A) Pasuri	703 080
Ndryshim likuiditeti	703 080
B) Detyrime	0
C) Pasuri neto (A-B)	703 080
D) Të ardhura	1 295 629
Të ardhura nga paga prej ushtrimit të detyrës, subjekti i rivlerësimit	541 260
Të ardhura nga ushtrimi i aktivitetit tregtar, farmaci "****" (bashkëshortja)	641 027
Të ardhura nga paga prej ushtrimit të farmaci "****" (bashkëshortja)	78 800
Të ardhura nga ISSH-ja, bashkëshortja e subjektit	34 542
E) Shpenzime	186 397
Shpenzime jetike	186 397
Balanca e fondeve (D-C-E)	406 152

Tabela nr. 4.

<i>Analiza financiare, për verifikimin mundësisë për investimin e kryer në datën 12.12.2006, për krijimin e depozitës në shumën prej 1,000,000 lekësh në "ISP Bank" (Vlerat në lekë)</i>	1.1.2006 - 12.12.2006
A) Pasuri	1 620 937
Ndryshim likuiditeti	1 620 937
B) Detyrime	0
C) Pasuri neto (A-B)	1 620 937
D) Të ardhura	2 059 725
Të ardhura nga paga prej ushtrimit të detyrës, subjekti i rivlerësimit	796 107
Të ardhura nga ushtrimi i aktivitetit tregtar, farmaci "****" (bashkëshortja)	1 071 476
Të ardhura nga paga prej ushtrimit të farmaci "****" (bashkëshortja)	157 600
Të ardhura nga ISSH-ja, bashkëshortja e subjektit	34 542
E) Shpenzime	311 562
Shpenzime jetike	311 562
Balanca e fondeve (D-C-E)	127 225

Tabela nr. 5.

<i>Analiza financiare për verifikimin mundësisë për investimin e kryer në datën 3.7.2008, për krijimin e depozitës në shumën prej 500,000 lekësh në "Union Bank" (Vlerat në lekë)</i>	1.1.2008- 3.7.2008
A) Pasuri	591 044
Ndryshim likuiditeti	591 044
B) Detyrime	0
C) Pasuri neto (A-B)	591 044
D) Të ardhura	1 959 138
Të ardhura nga paga prej ushtrimit të detyrës, subjekti i rivlerësimit	474 630
Të ardhura nga paga si pedagog, universiteti "****", subjekti i rivlerësimit	571 545
Të ardhura nga ushtrimi i aktivitetit tregtar, farmaci "****" (bashkëshortja)	649 188
Të ardhura nga paga prej ushtrimit të farmaci "****" (bashkëshortja)	180 000

Të ardhura nga interesat bankarë të depozitave me afat	83 775
E) Shpenzime	205 491
Shpenzime jetike	205 491
Balanca e fondeve (D-C-E)	1 162 603

Tabela nr. 6.

<i>Analiza financiare për verifikimin mundësisë për investimin e kryer në datë 8.7.2008, për krijimin e depozitës në shumën prej 500,000 lekësh në "Union Bank" (Vlerat në lekë)</i>	1.1.2008 - 8.7.2008
A) Pasuri	1 091 044
Ndryshim likuiditeti	1 091 044
B) Detyrime	0
C) Pasuri neto (A-B)	1 091 044
D) Të ardhura	1 976 876
Të ardhura nga paga prej ushtrimit të detyrës, subjekti i rivlerësimit	474 630
Të ardhura nga paga si pedagog, universiteti "****", subjekti i rivlerësimit	571 545
Të ardhura nga ushtrimi i aktivitetit tregtar, farmaci "****" (bashkëshortja)	666 926
Të ardhura nga paga prej ushtrimit të farmaci "****" (bashkëshortja)	180 000
Të ardhura nga interesat bankarë të depozitave me afat	83 775
E) Shpenzime	211 106
Shpenzime jetike	211 106
Balanca e fondeve (D-C-E)	674 726

Tabela nr. 7.

<i>Analiza financiare për verifikimin mundësisë për investimin e kryer në datën 8.7.2008, për krijimin e depozitës në shumën prej 1,000,000 lekësh në "Union Bank" (Vlerat në lekë)</i>	1.1.2009 -5.8.2009
A) Pasuri	974 605
Ndryshim likuiditeti	974 605
B) Detyrime	0
C) Pasuri neto (A-B)	974 605
D) Të ardhura	1 867 723
Të ardhura nga paga prej ushtrimit të detyrës, subjekti i rivlerësimit	554 285
Të ardhura nga paga si pedagog, universiteti "****", subjekti i rivlerësimit	571 851
Të ardhura nga ushtrimi i aktivitetit tregtar, farmaci "****" (bashkëshortja)	437 151
Të ardhura nga paga prej ushtrimit të farmaci "****" (bashkëshortja)	153 000
Të ardhura nga interesat bankarë të depozitave me afat.	151 436
E) Shpenzime	241 424
Shpenzime jetike	241 424
Balanca e fondeve (D-C-E)	651 4

38.2. Sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur (bashkëshortja) kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive të llojit "depozitë bankare" në "Intesa SanPaolo Bank" dhe "Union Bank".

39. Depozitë bankare në BKT, krijuar në datën 8.3.2013, me vlerë 1,500,000 lekë.

Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se kjo depozitë është shtuar me shumën prej 163,200 lekësh, e cila përfaqëson vlerën totale të interesave të përfituar, të cilat nuk janë tërhequr, duke iu bashkuar depozitës fillestare.

39.1. Si burim krijimi të depozitës me vlerë 1,500,000 lekë, subjekti ka deklaruar se kanë shërbyer të ardhurat e përfituara si pjesë takuese nga shitja e apartamentit në bashkëpronësi me prindërit, përfituar më parë me ligjin e privatizimit.

Deklarimi i kësaj pasurie në vite

40. Në DIP/2013, subjekti ka deklaruar krijimin e depozitës bankare në datën 8.3.2013 në BKT, me vlerë 1,500,000 lekë, me burim krijimi të ardhurat nga shitja e pjesës së tij në apartamentin e banimit, pasuria nr. ***, zona kadastrale nr. ***, lagjja “****”, Fier.

40.1. Në DIP/2015, subjekti ka deklaruar se ka shtuar depozitën në BKT, të deklaruar në vitin 2013, me shumën prej 163,200 lekësh.

41. Konkluzioni i ILDKPKI-së për këtë pasuri: përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar, përgjigjen e BKT-së, ZVRPP-së Fier dhe DPPPP-së.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni për këtë pasuri dhe të ardhurat e deklaruara si burim krijimi i saj

42. BKT-ja²⁸ konfirmon se në datën 8.3.2013 subjekti i rivlerësimit ka depozituar *cash* në llogarinë e tij në këtë bankë, shumën prej 1,500,000 lekësh, e cila është investuar në depozitë me afat 2-vjeçar. Gjithashtu, referuar dokumentacionit bankar të administruar në dosje konstatohet se në datën 8.3.2015, kjo depozitë është maturuar dhe është përfituar interesi bankar në shumën prej 163,200 lekësh dhe se nga kjo llogari, po në datën 8.3.2015, shuma totale e akumuluar prej 1,663,200 lekësh është investuar në depozitë me afat 2-vjeçar.

42.1. Në vijim të verifikimeve të kryera lidhur me të ardhurat e deklaruara si burim krijimi të kësaj pasurie, Komisioni konstaton se në deklaratën fillestare të pasurisë (depozituar në ILDKPI në datën 19.3.2003), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron 33% pjesë takuese të pasurisë së llojit “apartament banimi”, të ndodhur në Fier, përfituar me ligjin “Për privatizimin e banesave shtetërore”. Ndërsa, në DIP/2013, në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit” subjekti ka deklaruar se ka shitur pjesën e tij takuese në këtë apartament, në shumën 1,500,000 lekë (kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.3.2013).

42.2. ASHK-ja, Drejtoria Vendore Fier²⁹, konfirmon se subjekti së bashku me prindërit e tij, kanë pasur në bashkëpronësi pasurinë me të dhënat e mësipërme, e cila ka pësuar transaksion dhe nuk është më pronë e tyre.

42.3. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit administrativ³⁰ lidhur me këtë pasuri, Komisioni konstaton se:

i) në datën 7.12.1993, babai i subjektit ka lidhur kontratë³¹ me Ndërmarrjen Komunale të Banesave, për privatizimin e apartamentit me nr. ***, në pallatin nr. ***, shkalla ***, kati i dytë, të ndodhur në Fier, për vlerën prej 23,428 lekësh, i cili është regjistruar³² më pas në hipotekë në bashkëpronësi të subjektit dhe prindërve të tij.

²⁸ Shkresa e BKT-së me nr. *** prot., datë 28.5.2020, protokolluar me nr. *** prot., datë 29.5.2020.

²⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 9.6.2020, protokolluar me nr. *** prot., datë 12.6.2020.

³⁰ Dokumentacioni i depozituar nga subjekti në dosjen e ILDKPKI – me dorëzimin e deklaratës “Vetting”; dokumentacioni pjesë e dosjes së hetimit të bërë nga ILDKPKI; dhe dokumentacioni pjesë e dosjes hetimit të bërë nga KPK.

³¹ Kontrata për privatizimin e banesës, datë 7.12.1993, konfirmuar me vërtetim nënshkrimi me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.4.1996.

³² Sipas certifikatës për vërtetim pronësie nr. ***, lëshuar në datën 29.9.2008.

ii) referuar informacionit/dokumentacionit të dërguar nga “Raiffeisen Bank”³³ konstatohet se në datën 7.3.2013, në llogarinë e babait të subjektit, z. Sh.B, është kredituar shuma prej 3,000,000 lekësh, nëpërmjet trasfertës bankare të bërë nga shtetasi M.C, me përshkrimin “*Kalim llogari blerje shtëpie*”.

iii) në datën 8.3.2013, subjekti i rivlerësimit dhe dy prindërit e tij ia shesin³⁴ pasurinë e sipërcituar shtetasit M.C, për çmimin prej 4,500,000 lekë, shumë e cila, referuar kontratës, deklarohet se është likuiduar mes palëve jashtë zyrës noteriale.

iv) siç u konstatua më sipër, po në datën 8.3.2013, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka depozituar *cash* në llogarinë e tij në BKT, shumën prej 1,500,000 lekësh, e cila pasi është investuar në depozitë me afat dhe pasi është maturuar, duke u investuar sërish, figuron gjendje në llogarinë bankare të subjektit, deklaruar prej tij në deklaratën “Vetting” në seksionin e deklarimit të pasurive.

Pra, bazuar në dokumentacionin e referuar si më sipër, konfirmohet pjesa takuese e subjektit nga shitja e kësaj pasurie është në shumën prej 1,500,000 lekësh, e cila, pasi është përfituar nga subjekti ditën e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, është depozituar në BKT.

42.4. Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me pasurinë objekt vlerësimi - depozitën në BKT - dhe arrin në përfundimin se nuk ka dyshime për burimin e krijimit të saj.

43. Depozitë bankare në BKT, krijuar në datën 11.8.2015, me vlerë 3,000,000 lekë

43.1. Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka referuar se ka shërbyer gjendja *cash* e deklaruar për vitin 2014, krijuar me të ardhurat nga puna e tij dhe e bashkëshortes.

Deklarimi i kësaj pasurie në vite

44. Në DIP/2014, në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, subjekti ka deklaruar se ka shtuar gjendjen *cash*, në shumën prej 3,000,000 lekësh, me burim të ardhurat e realizuara prej tij dhe personit të lidhur (bashkëshortes) gjatë këtij viti.

44.1. Në DIP/2015, në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, subjekti ka deklaruar krijimin e depozitës bankare në BKT, me vlerë 3,000,000 lekë, me burim krijimi të gjithë gjendjen e deklaruar *cash* për vitin 2014.

45. Konkluzioni i ILDKPKI-së për këtë pasuri: është i dyshimtë krijimi i gjendjes *cash* prej 3,000,000 lekësh në vitin 2014, me burim kursimet familjare për periudhën, shumë e cila ka shërbyer si burim për krijimin e depozitës në vitin 2015.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni për këtë pasuri dhe të ardhurat e deklaruara si burim krijimi i saj

46. BKT-ja³⁵ konfirmon se në emër të subjektit të rivlerësimit figuron llogaria “depozitë” në monedhën lekë, në shumën prej 3,000,000 lekësh. Nga verifikimi i lëvizjeve të kësaj llogarie rezulton se në datën 11.8.2015 subjekti ka depozituar *cash* shumën prej 3,000,000 lekësh, e cila është investuar dhe vijon të jetë e investuar në depozitë me afat.

46.1. Bazuar në analizën e treguesve financiare të kryer nga Komisioni³⁶ konstatohet se rezultati i vitit 2014, vit në të cilin është deklaruar krijimi i gjendjes *cash* në shumën prej 3,000,000 lekësh, referuar në vijim si burim krijimi i pasurisë objekt vlerësimi, paraqitet me balancë pozitive fondesh. Pra, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur (bashkëshortja) kanë pasur të ardhura nga

³³ Shkresa e “Raiffeisen Bank” me nr. *** prot., datë 6.5.2020, protokolluar me nr. *** prot., datë 11.5.2020.

³⁴ Kontratë shitblerjeje e pasurisë së paluajtshme me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.3.2013, redaktuar nga noteri publik, znj. F.Z.

³⁵ Shkresa e BKT-së me nr. *** prot., datë 28.5.2020, protokolluar me nr. *** prot., datë 29.5.2020.

³⁶ Referohu tabelës së analizës përmbledhëse të treguesve financiarë të kryer nga Komisioni, Aneks 1 – pjesë e këtij vendimi.

burime financiare të ligjshme, të cilat mundësojnë plotësisht krijimin e kursimeve në formë likuiditetesh *cash* në shumën prej 3,000,000 lekësh përgjatë vitit 2014.

46.2. Sa më sipër, Komisioni konstaton se janë deklaruar saktë të dhënat lidhur me pasurinë objekt vlerësimi – depozitën në BKT- dhe arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur (bashkëshortja) kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e kësaj pasurie.

47. Depozitë në Bankën Amerikane të Investimeve, e krijuar në datën 17.10.2016, me vlerë **5,000,000 lekë**

47.1. Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka referuar se ka shërbyer gjithë gjendja *cash* e krijuar dhe e deklaruar në vite, në shumën prej 4,500,000 lekësh, ndërsa pjesa tjetër nga të ardhurat e vitit 2016, nga puna e tij dhe e bashkëshortes, deri në momentin e depozitimit.

Deklarimi i likuiditeteve *cash* ndër vite dhe i krijimit të kësaj depozite në vitin 2016

48. Në DIP/2005, subjekti ka deklaruar gjendje *cash*, shumën prej 1,500,000 lekësh.

48.1. Në DIP/2011 ka deklaruar shtesë likuiditetesh në gjendje *cash* shumën prej 1,000,000 lekësh, me burim të ardhurat nga puna e tij dhe e bashkëshortes.

48.2. Në DIP/2014 ka deklaruar shtesë likuiditetesh në gjendje *cash* shumën prej 3,000,000 lekë, me burim të ardhurat e realizuara gjatë atij viti.

48.3. Në DIP/2015 ka deklaruar pakësimin e gjendjes *cash* të deklaruar për vitin 2014 (shumën prej 3,000,000 lekësh), investuar kjo shumë si depozitë në BKT. Gjithashtu, ka deklaruar shtesë të gjendjes së likuiditeteve *cash* në shumën prej 2,500,000 lekësh, me burim të ardhurat e krijuara përgjatë këtij viti. Pra, referuar vetëdeklarimeve të bëra, rezulton se deri në fund të vitit 2015, subjekti i rivlerësimit dispononte gjendjen e likuiditeteve *cash* në shumën prej 5,000,000 lekësh.

48.4. Në DIP/ 2016, subjekti ka deklaruar krijimin e depozitës bankare në Bankën Amerikane të Investimeve, në shumën prej 5,000,000 lekësh, krijuar më 17.10.2016, me burim pakësimin e gjendjes *cash* të deklaruar në vite, në shumën prej 4,500,000 lekësh, ndërsa pjesën tjetër nga të ardhurat e vitit 2016. Gjithashtu, ka deklaruar se disponon gjendjen *cash* në shumën prej 1,400,000 lekësh, me burim krijimi të ardhurat e vitit 2016.

48.5. Pra, nga verifikimi dhe analizimi i deklarimeve të bëra lidhur me likuiditetet *cash* në vite (shtesa/pakësime/gjendje) Komisioni konstaton se ka mospërputhje në deklaratimet e subjektit sa i përket gjendjes së likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2015.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni për këtë pasuri dhe të ardhurat e deklaruara si burim krijimi i saj

49. Banka Amerikane e Investimeve (sot “ABI BANK”)³⁷ konfirmon se në datën 17.10.2016 subjekti i rivlerësimit ka depozituar *cash* në llogarinë e tij personale, shumën prej 5,000,000 lekësh, me përshkrimin “*depozitë nga Taulant Banushi, të ardhura nga kursimet në vite*”, duke e investuar në depozitë me afat 3-vjeçar.

49.1. Bazuar në analizën e treguesve financiarë të kryer nga Komisioni³⁸ konstatohet se rezultatet e viteve gjatë të cilave janë deklaruar shtesa likuiditetesh *cash*, por edhe i vitit 2016 (të ardhurat e të cilit janë deklaruar si burim krijimi i pasurisë objekt vlerësimi), paraqiten me balancë pozitive fondesh. Pra, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme, të cilat mundësojnë plotësisht krijimin e kursimeve në formë likuiditetesh

³⁷ Shkresa e “ABI Bank” me nr. *** prot., datë 30.4.2020, protokolluar me nr. *** prot., datë 11.5.2020.

³⁸ Referoju tabelës së analizës përmbledhëse të treguesve financiarë të kryer nga Komisioni, Aneks 1 – pjesë e këtij vendimi.

cash të deklaruara deri në fund të vitit 2015, në shumën prej 4,500,000 lekësh, por edhe për krijimin e vlerës prej 500,000 lekësh gjatë vitit 2016.

49.2. Sa më sipër, Komisioni konstaton se janë deklaruar saktë të dhënat lidhur me pasurinë objekt vlerësimi, depozitën në “ABI Bank” dhe arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur (bashkëshortja) kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e kësaj pasurie.

Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

50. Nga hetimi administrativ dhe shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting” ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, sipas parashikimeve në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

50.1. Subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë, në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Ai ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të tij dhe personave të lidhur. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Taulant Banushi, nuk vërtetohen shkaqe që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohesh parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

50.2. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

51. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Taulant Banushi, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ai ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

51.1. Me shkresën e datës *** prot., datë 2.11.2017, është përcjellë në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit raporti për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, me konstatimin **përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës.**

51.2. Në vijim të informacioneve të ardhura nga institucioni i verifikimit, në kohështrirje përpara dhe gjatë periudhës së rivlerësimit, referuar raportit të përditësuar³⁹ të dërguar nga DSIK-ja ka rezultuar se për subjektin e rivlerësimit, Taulant Banushi, informohet se disponohen të dhëna për përfshirje në veprimtari korruptive, gjatë disa proceseve penale dhe civile në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

51.3. Insitucionet verifikuese kanë ndarë informacione me organet ligjzbatuese, konkretisht drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, ku ndër të tjera thuhet se: *“Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier po procedohet çështja në ngarkim të një shtetasi, i cili akuzohet se ka vjedhur një shumë parash...si edhe shpërdorim detyre...ku ndër të tjera Taulant Banushi në vazhdimësi dhe me ndërmjetësimin e avokatit të çështjes, i kanë kërkuar...shumën...në këmbim të një mase dënimi më të ulët...”*

51.4. Për subjektin e rivlerësimit Taulant Banushi, DSIK-ja vlerëson të merren parasysh elementet që tregojnë përfshirjen e tij në veprimtari korruptive, pasi në frymën kundër korrupsionit, sipas ligjit nr. 84/2016, vlerësohet se integriteti profesional është përcaktues për pastërtinë e figurës së subjekteve të rivlerësimit.

51.5. Si përfundim, DSIK-ja ka parashtruar se:

i) informacionet që disponohen për subjektin e rivlerësimit, vlerësohen për aktualitetin e tyre, kohëzgjatjen, pra më shumë se një herë, të përfshirjes apo implikimit në veprimtari të

³⁹ Raporti me nr. *** prot., datë 12.2.2021, deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr. *** , datë 18.3.2021.

kundërligjshme, në formën e korrupsionit pasiv të gjyqtarit, në papajtueshmëri të plotë me ushtrimin e detyrës së tij funksionale;

ii) informacionet që disponohen në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, për implikim në veprimtari korruptive të funksionarit të drejtësisë, në këtë rast të një gjyqtari, nëpërmjet premtimit apo kërkimit të drejtpërdrejtë apo tërthorazi, të çfarëdolloj përfitimi të parregullt, për të kryer ose moskryer një veprim, që lidhet me detyrën e tij funksionale, cenon drejtpërsëdrejti pastërtinë e figurës, çfarë përmbush plotësisht përcaktimet e germave “b” dhe “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016, ku Taulant Banushi, vlerësohet si individ i mundshëm për t’u vënë nën presion nga strukturat kriminale.

51.6. Për sa më sipër, në raportin e përditësuar, grupi i punës në DSIK ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, z. Taulant Banushi, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në **papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës.**

51.7. Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit të subjektit të rivlerësimit, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve/sinjalizimeve të dërguara/të përfituara nga agjencitë ligjzbatuese.

51.8. Bazuar në kërkesën e bërë nga Komisioni⁴⁰, Prokuroria e Përgjithshme informon se nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e kallëzimeve dhe procedimeve penale të kësaj prokurorie rezulton se ndaj subjektit të rivlerësimit nuk ka çështje penale apo kallëzim penal të filluar dhe se nga kontrolli i ushtruar në mënyrë manuale, në regjistrat e ankesave për periudhën 2006 – 2020, rezulton se nuk ka ankesë të regjistruar ndaj këtij subjekti⁴¹. Në vijim, nga verifikimi i bërë në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun⁴² për praktikën e trajtuara, nuk rezulton që të ketë ankesa për subjektin e rivlerësimit.

51.9. Gjithashtu, Prokuroria e Përgjithshme ka përcjellë⁴³ të gjithë informacionin për subjektin e rivlerësimit, të ardhur nga prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore me juridiksion të përgjithshëm.

51.10. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar⁴⁴ konfirmon se në regjistrin e njoftimit të veprave penale të kësaj prokurorie nuk rezulton që në emër të subjektit të rivlerësimit të jetë regjistruar ndonjë procedim penal. Gjithashtu, pas verifikimit të regjistrin të njoftimit të veprave penale të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, nuk rezulton që në emër të subjektit të rivlerësimit të jetë regjistruar ndonjë procedim penal. Por, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar informon se:

i) ndaj këtij shtetasi (subjektit të rivlerësimit) janë kryer verifikime në kuadrin e procedimit nr. ***, viti 2019. Ky procedim është regjistruar kryesisht mbi bazën e pamjeve filmike të emisionit investigativ “****” të televizionit “****”, për nenet 245/1 dhe 319/ç të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve R.H., dhe E.M. Ky shtetas (i referohen subjektit të rivlerësimit) është përmendur në vendimin e regjistrimit të këtij procedimi, në bisedën e bërë midis tij dhe psikologes E.M., gjatë shfaqjes së pamjeve filmike të regjistruara, *por emri i tij nuk është i regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale të ish-Prokurorisë së Krimeve të Rënda Tiranë.*

ii) ndaj subjektit të rivlerësimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda është regjistruar kallëzimi penal me nr. ***, i vitit 2015, për të cilin është vendosur mosfillim procedimi. Nga verifikimi i dosjes së dërguar rezulton se ky material kallëzues është regjistruar

⁴⁰ Shkresa nr. *** prot., datë 28.4.2020.

⁴¹ Shkresa e Drejtorisë së Menaxhimit të Dokumentacionit, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse - pranë Prokurorisë së Përgjithshme, me nr. *** prot., datë 21.5.2020, përcjellë me shkresën e Prokurorisë së Përgjithshme me nr. *** prot., datë 29.9.2020, protokolluar me nr. *** prot., datë 30.9.2020.

⁴² Shkresa e Drejtorisë së Koordinimit Institucional pranë Prokurorisë së Përgjithshme, me nr. *** prot., datë 12.5.2020, përcjellë me shkresën e Prokurorisë së Përgjithshme me nr. *** prot., datë 29.9.2020, protokolluar me nr. *** prot., datë 30.9.2020.

⁴³ Shkresa e Prokurorisë së Përgjithshme me nr. *** prot., datë 29.9.2020, protokolluar me nr. *** prot., datë 30.9.2020.

⁴⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 1.6.2020, përcjellë me shkresën e Prokurorisë së Përgjithshme me nr. *** prot., datë 29.9.2020, protokolluar me nr. *** prot., datë 30.9.2020.

bazuar në ankesën e bërë nga shtetasi H.M., në portalin online “Stop Korrupsionit.al” të Ministrisë së Drejtësisë, përcjellë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda nga Drejtoria Task Forcë pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Konstatohet se kallëzuesi, shtetasi H.M., është deklaruar fajtor dhe është dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, e përbërë nga trupi gjykues me gjyqtar subjektin e rivlerësimit, për konsumimin e veprave penale të “Shkatërrimi i pronës” dhe “Dhunimi i banesës”, të kryera në bashkëpunim. Kallëzuesi ka pretenduar se ai është dënuar, pasi nuk ka pasur mundësi të paguajë gjyqtarin Banushi me një vlerë të caktuar monetare, sipas tij të kërkuar nëpërmjet avokatit A.T., (avokatit të tij). Pas verifikimeve të kryera mbi pretendimet e ngritura në kallëzim nga prokurori i çështjes është vlerësuar se ato nuk ekzistojnë, duke vendosur në datën 25.1.2016, mosfillimin e procedimit penal.

51.11. Në vijim të verifikimit të dokumentacionit të dërguar nga Prokuroria e Përgjithshme rezultoi se Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier⁴⁵ ka informuar se për subjektin e rivlerësimit ka regjistruar kallëzimin penal me nr. ***, datë 17.2.2015, mbi bazën e kallëzimit të paraqitur nga shtetasi N.D., për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodi Penal. Nga verifikimi i dosjes së dërguar rezultoi se ky material kallëzues është regjistruar bazuar në pretendimet e ngritura në kallëzimin e bërë në datën 16.2.2017 nga shtetasi N.D., të cilat duket se lidhen me vendimin e gjyqtarit Banushi për rrëzimin e kërkesës për fillimin e procedimit penal në lidhje me një çështje tjetër, për të cilën Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier kishte vendosur më parë mosfillimin e hetimeve, mbi faktet e kallëzuara pikërisht nga shtetasi N.D. Pas verifikimeve të kryera mbi pretendimet e ngritura në kallëzim, prokurori i çështjes ka vlerësuar se nuk gjenden elemente të ndonjë veprave penale që të jetë parashikuar nga ligji penal në një figurë konkrete veprave penale, duke vendosur në datën 23.2.2017 mosfillimin e procedimit penal.

51.12. Komisioni ka kryer edhe veprime të tjera hetimore mbi informacionet/sinjalizimet e përfuara nga organet e verifikimit për mundësinë e ekzistencës së kontakteve të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe/apo përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, porse nga hetimi administrativ i kryer, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

51.13. Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, në lidhje me përfundimet e raportit të përditësuar/ndryshuar të paraqitur nga Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se: i) *ato nuk i përgjigjen së vërtetës dhe kanë rezultuar mbi bazën e informacioneve të paverifikuara;* ii) *nga hetimi i thelluar administrativ ka rezultuar se e gjithë pasuria që zotërohet prej tij ka rrjedhur nga burime të ligjshme dhe nuk rezultoi që të ketë pasuri të fshehura dhe të padeklaruara;* iii) *edhe nga aktet që ndodhen në dosjen e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, ka rezultuar se ai nuk ka qenë kurrë person nën hetim për kryerjen e ndonjë veprave penale dhe emri i tij nuk ka qenë kurrë i regjistruar në regjistrat e njoftimit të veprave penale në asnjë prokurori të juridiksionit të zakonshëm apo të posaçëm;*

51.14. Gjithashtu, subjekti ka parashtruar se *raporti i përditësuar i DSIK është krejtësisht abuziv dhe i pambështetur në asnjë fakt, rrethanë dhe aq më pak në ndonjë provë, se ai mund të jetë individ i mundshëm për t'u vënë nën presion nga strukturat kriminale, duke deklaruar se zotëron një pasuri të ligjshme dhe nuk ka pasur qoftë edhe një rast të vetëm, ku vendimmarrja e tij të ketë favorizuar ndonjë strukturë kriminale, ndërkohë që nuk ka pasur qoftë edhe një kontakt rastësor me ndonjë person të përfshirë në këto struktura.*

⁴⁵ Shkresa e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier me nr. *** prot., datë 13.5.2020, përcjellë me shkresën e Prokurorisë së Përgjithshme me nr. *** prot., datë 29.9.2020, protokolluar me nr. *** prot., datë 30.9.2020.

Analiza e provave të administruara në dosje dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit. Vlerësimi përfundimtar i Komisionit për kriterin e kontrollit të figurës

52. Komisioni vëren se informacionet e përcjella nga institucioni i verifikimit, mbi bazën e të cilave është përditësuar/ndryshuar raporti i DSIK-së, nuk pasqyrojnë raste konkrete mbi të cilat mund të provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm ekzistenca e kontakteve të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe/apo përfshirja e tij në veprimtari të kundërligjshme.

52.1. Nga ana tjetër rezulton se informacioni i dërguar nga institucioni i verifikimit në institucionin e Prokurorit të Përgjithshëm, nuk ka pasqyruar regjistrimin e ndonjë kallëzimi apo procedimi penal në ngarkim të subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, në informacionin e DSIK-së nuk janë pasqyruar as çështje konkrete, në të cilat dyshohet se subjekti i rivlerësimit të jetë përfshirë në veprimtari të kundërligjshme, në formën e shpërdorimit të detyrës.

52.2. Sa më sipër, nga analizimi në tërësi i shpjegimeve të dhëna nga subjekti dhe provave të administruara gjatë hetimit administrativ, Komisioni arrin në përfundimin se për subjektin e rivlerësimit nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

53. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Taulant Banushi, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI PROFESIONAL

Raporti i mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor

54. Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi ndihmës për vlerësimin profesional, në bazë të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

54.1. Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (1) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti; (2) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe (3) të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së.

54.2. Të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së: sipas të dhënave nga databaza e ankesave rezulton se gjatë periudhës trivjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 - 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Taulant Banushi janë paraqitur gjithsej 10 ankesa (2 në vitin 2013, 5 në vitin 2014, 3 në vitin 2015) në Inspektoratin e ish- KLD-së.

- 9 ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit paraprak, me arsyetimin se 3 prej tyre (1 e vitit 2013, 1 e vitit 2014, 1 e vitit 2015) ishin ankesa të përsëritura, 2 prej tyre (1 e vitit 2013, 1 e vitit 2014) mund të zgjidheshin përmes apelimit gjyqësor në gjykatat më të larta dhe 2 prej tyre (të vitit 2014) janë arkivuar, pasi nuk ka pasur vend për verifikim. Dy ankesat e tjera (1 e vitit 2014 e 1 e vitit 2015) janë arkivuar, si ankesa që nuk përbënin objekt të veprimtarisë së Inspektoratit.

- 1 ankesë (e vitit 2015) ishte verifikuar për mosrespektim të disiplinës, por është vendosur arkivimi i saj, pasi nuk kanë rezultuar shkelje nga ana e gjyqtarit.

54.3. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Taulant Banushi përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk rezulton që ndaj tij të ketë ardhur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor dhe të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

54.4. Nga analiza e të dhënave referuar kritereve të vlerësimit profesional ka rezultuar se:

Për aftësitë profesionale: zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës për një proces të rregullt ligjor; vetëm në një rast çështja është kthyer për rigjykim; ka tipar të punës së tij fokusimin e arsytimit të vendimit tek thelbi i çështjes dhe konkretizimin sipas rastit në mosmarrëveshje;

Për aftësitë organizative: ka pasur ngarkesë sasiore nën standardin minimal, por i ka kushtuar rëndësinë e duhur kohëzgjatjes së gjykimit dhe sidomos arsytimit të shpejtë të vendimeve gjyqësore. Në 14 dosje të vëzhguara, vetëm 3 prej tyre nuk kanë qenë produktive, si pasojë e mosparaqitjes së prokurorit. Gjithashtu, vetëm në një dosje procesverbali i seancës gjyqësore i administruar në dosje rezulton jo i saktë e në përputhje me kërkesat e nenit 345 të Kodit të Procedurës Penale.

Për etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale: gjyqtari komunikon me etikë dhe nuk rezulton të ketë përdorur gjuhë diskriminuese me palët në proces; ai ka marrë pjesë në mënyrë të vazhdueshme në trajnimet e Shkollës së Magjistraturës dhe jashtë programit të saj.

54.5. Me dërgimin e rezultateve të hetimit Komisioni i kërkoi subjektit shpjegimet mbi gjetjet e konstatuara në raportin për analizën e aftësive profesionale të hartuar nga KLGJ-ja.

Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni

55. Hetimi i Komisionit, lidhur me këtë kriter, është bazuar në verifikimin dhe analizimin e: (i) raportit për analizimin e aftësive profesionale të mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor; (ii) vlerësimit të denoncimeve të paraqitura dhe shqyrtimit të dokumentacionit të administruar që lidhet me çështjet objekt ankimi nga subjektet denoncues; (iii) vlerësimit dhe analizimit të disa dosjeve të tjera gjyqësore të shqyrtuara nga subjekti i rivlerësimit, të administruara në vijim të verifikimit të sinjalizimeve të përfituara nga organet e tjera ligjzbatuese; dhe (iv) kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

55.1. Komisioni, me qëllim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet e përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të ish-KLD-së (KLGJ-së).

55.2. Në këtë kuadër, Komisioni vlerëson se me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar dhe arsyetuar në mënyrë bindëse mbi gjetjet e listuara në raportin për analizën e aftësive profesionale të hartuar nga KLGJ-ja, duke depozituar edhe prova të reja në mbështetje të shpjegimeve të tij. Si përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika thelbësore lidhur me vlerësimin e kriterit profesional.

55.3. Në vlerësimin e gjyqtarit Banushi u mbajtën në vëmendje dhe u analizuan edhe 16 (gjashtëmbëdhjetë) denoncime të depozituara nga publiku në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Nga analizimi i detajuar i denoncimeve të shtetasve A.Rr⁴⁶, L.B⁴⁷, A.J⁴⁸, B.M⁴⁹, nuk u vërejtën fakte apo rrethana, të tilla që, të përbënin prova për gjetje mbi bazën e të cilave do mund të vlerësohej veprimtaria e subjektit të rivlerësimit, për aspekte që lidhen me vlerësimin e kriterit etiko – profesional.

Nga shqyrtimi i një denoncimi anonim⁵⁰ rezultoi se çështja nuk i përkiste periudhës së vlerësimit të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit për efekt të këtij procesi.

⁴⁶ Ankesa nr. *** prot., datë 29.12.2017.

⁴⁷ Ankesa nr. *** prot., datë 18.5.2018.

⁴⁸ Ankesa nr. *** prot., datë 1.11.2019 dhe nr. *** prot., datë 30.12.2020.

⁴⁹ Ankesa nr. *** prot., datë 22.10.2021.

⁵⁰ Ankesa nr. *** prot., datë 16.8.2018.

Në vijim, denoncimet e shtetasve N.Z⁵¹, H.S⁵², shoqërisë “OSHEE” sh.a.⁵³, K.B⁵⁴, Th.Ç⁵⁵ kishin të bënin me themelin e çështjes dhe vendimmarrjen e gjyqtarit, garant për shqyrtimin e të cilave janë gjykatat e nivelit më të lartë.

Nga verifikimi i denoncimeve të shtetasve A.H⁵⁶ dhe M.K⁵⁷, Komisioni konstaton se denoncuesit nuk kanë paraqitur të dhëna/fakte dhe/apo dokumentacion mbi bazën e të cilave do mund të vlerësohej veprimtaria e gjyqtarit Taulant Banushi, lidhur me kriterin etiko – profesional.

Ndërsa, denoncuesit A.Q.J dhe M.B.J⁵⁸, në denoncimin e tyre nuk kanë paraqitur fakte apo rrethana për të provuar shkaqet e cituara në kërkesën e përjashtimit të gjyqtarit Banushi, të tilla që mund të përbënin prova në lidhje me vlerësimin e kriterit etiko – profesional dhe shqyrtimi i kërkesës së tyre nuk është në kompetencë të Komisionit.

Komisioni u ndal në 4 denoncime për subjektin e rivlerësimit si më poshtë:

Denoncimet e shtetasit S.B⁵⁹

56. Denoncuesi ngre pretendime lidhur me shqyrtimin e një çështjeje civile dhe mbi vendimmarrjen nga gjyqtari Banushi. Pas kërkesës së bërë nga Komisioni⁶⁰, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier dërgoi⁶¹ dokumentacionin që lidhet me çështjen objekt denoncimi, si vijon: (i) vendimin civil me nr. ***, datë 24.5.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; dhe (ii) vendimin civil me nr. ***, datë 29.10.2019, të Gjykatës së Apelit Vlorë. Gjithashtu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka informuar se dosja gjyqësore me nr. ***, datë 24.5.2017, e kësaj gjykate, ndodhet për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

56.1. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar konstatohet se:

i) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier (në përbërje të trupit gjykues të së cilës si anëtar i vetëm është subjekti i rivlerësimit, z. Taulant Banushi), për çështjen me palë paditëse, denoncuesin S.B; me palë të paditur shtetasit, F.P., A.M., dhe K.G.; me objekt: “Njohje e pronësisë mbi sipërfaqen prej 45 m², si pjesë e pasurisë nr. ***, zona kadastrale nr. ***, e ndodhur në lagjen “****”, Fier, në funksion të kontratës së dhurimit nr. *** regj., nr. *** kol., datë 10.8.1996” dhe “Kërkimi dhe kthimi i sendit nga të paditurit”, në datën 24.5.2017, ka vendosur⁶²: rrëzimin e padisë.

ii) Pas ankimit të bërë nga paditësi, z. S.B, Gjykata e Apelit Vlorë, në datën 29.10.2019, ka vendosur⁶³: prishjen e vendimit nr. ***, datë 24.5.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, si dhe kthimin e akteve për rishqyrtim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

56.2. Referuar këtij vendimi, Gjykata e Apelit, gjatë shqyrtimit të çështjes në shkallë të dytë, ndër të tjera, ka çmuar se përfundimi i arritur nga Gjykata e Shkallës së Parë është rrjedhojë e **mosrespektimit të normave procedurale që lidhen me mungesën e një hetimi të plotë gjyqësor**, për shkak se **nuk u është dhënë përgjigje të gjitha kërkimeve të paditësit në padi, pretendimeve të tij të ngritura gjatë gjykimit, njëherazi prapësimeve të palës së paditur dhe për më tepër nuk**

⁵¹ Ankesa nr. *** prot., datë 24.10.2018.

⁵² Ankesa nr. *** prot., datë 16.8.2018.

⁵³ Ankesat nr. *** prot., datë 22.2.2019 dhe nr. *** prot., datë 11.3.2019.

⁵⁴ Ankesat nr. *** prot., datë 6.6.2019 dhe nr. *** prot., datë 11.7.2019.

⁵⁵ Ankesa e përcjellë nga Kolegji Posaçëm i Apelit me shkresën nr. *** prot., datë 30.9.2019, protokolluar me nr.*** prot., datë 1.10.2019.

⁵⁶ Ankesa e përcjellë nga institucioni i Komisionerëve Publikë, me shkresën nr. *** prot., datë 25.9.2019, protokolluar me nr. *** rep., datë 25.9.2019.

⁵⁷ Ankesa nr. *** prot., datë 21.2.2020.

⁵⁸ Ankesa e përcjellë nga institucioni i Komisionerëve Publikë, me shkresën nr. *** prot., datë 24.6.2020, protokolluar me nr. *** prot., datë 24.6.2020

⁵⁹ Ankesa me nr. *** prot., datë 7.12.2017 dhe ankesa me nr. *** prot., datë 27.6.2018.

⁶⁰ Shkresa nr. *** prot., datë 25.1.2022.

⁶¹ Shkresa nr. *** prot., datë 27.1.2021, protokolluar me nr. *** prot., datë 2.2.2022.

⁶² Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, nr. ***, datë 24.5.2017.

⁶³ Vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë, nr. ***, datë 29.10.2019.

është shprehur fare për padinë e konsideruar si gjë të gjykuar. Kjo gjykatë ka konstatuar se ndodhet para rastit të disponimit në shkelje të neneve 6 dhe 28 të Kodit të Procedurës Civile. Po kështu, sipas saj, vendimit **i mungon arsyetimi ligjor i tij**, pasi në rastin konkret vendimi nuk plotëson kushtet e parashikuara në nenet 309 e 310 të Kodit të Procedurës Civile.

56.3. Për sa më sipër, me dërgimin e rezultateve të hetimit administrativ, Komisioni kërkoi nga subjekti i rivlerësimit të japë shpjegime dhe argumente.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

57. Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar në mënyrë të detajuar argumentet e tij, duke depozituar si prova⁶⁴ në mbështetje të shpjegimeve të dhëna:

i) në lidhje me pretendimet e denoncuesit se subjekti i rivlerësimit e ka marrë vendimin në kushtet e korrupsionit, deklaroi se është një shpifje e ulët, e cila nuk ka asgjë të përbashkët me të vërtetën, sikundër edhe pretendimi se ai është ndëshkuar me një masë administrative, ndërkohë që nga aktet që i janë vënë Komisionit në dispozicion nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ka rezultuar e kundërta. Në vijim ka deklaruar se vendimin e ka marrë me bindjen e tij të brendshme, të formuar mbi bazën e provave që janë administruar gjatë gjykimit dhe i pandikuar nga asnjë faktor apo rrethanë tjetër e çfarëdolloji.

ii) në lidhje me përfundimet e arritura nga Gjykata e Apelit Vlorë ka argumentuar duke vlerësuar se, sipas tij, vendimi i saj vjen në kundërshtim me ligjin, është kontradiktor në arsyetim dhe është dhënë në rrethanat që gjykata nuk ka kuptuar thelbin e konfliktit mes palëve ndërgjyqëse, kjo pasi:

a) **për sa i përket konstatimit të Apelit se paditësi ka pretenduar fitimin e pronësisë me parashkrim fitues:** nuk rezulton të jetë ky pretendimi i paditësit, për më tepër nenet 162, 164, 165 dhe 199 të Kodit Civil, të cilëve u referohet Apeli, nuk kanë të bëjnë me parashkrimin fitues;

b) **lidhur me përfundimin e Apelit për mosshprehjen e Gjykatës për objektin e padisë dhe rrëzimin e saj si “gjë e gjykuar”:** pikërisht për faktin se objekti i padisë është njohja e pronësisë, Gjykata e Shkallës së Parë ka vendosur rrëzimin e saj, duke e vlerësuar si “gjë të gjykuar”, me arsyetimin se konflikti i pronësisë për atë send ishte zgjidhur me parë me vendim gjyqësor të formës së prerë.

c) **lidhur me përfundimin e Apelit se Gjykata e Shkallës së Parë nuk u ka dhënë përgjigje të gjitha kërkimeve të paditësit:** gjykata, pas analizimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, ka arritur në përfundimin se ky konflikt është zgjidhur më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe ka vendosur rrëzimin e padisë. Analiza e provave dhe arsyet e kësaj vendimmarrjeje janë të parashtruara në vendimin përkatës, i cili është administruar edhe nga Komisioni.

Subjekti ka shpjeguar se për këtë rast ka vlerësuar se gjendej përpara rastit klasik dhe të dukshëm të asaj që quhet “gjë e gjykuar”, ku në vendimin përkatës janë analizuar edhe elementet e saj, duke u mbështetur edhe në vendimin nr. 24, datë 12.11.2008, të Gjykatës Kushtetuese. Pra, sipas tij, në rastin konkret nuk ka asnjë shkelje të neneve 6 dhe 28 të K.Pr.Civile, pasi gjykata është shprehur për kërkimin e paditësit, duke e rrëzuar atë, për shkak se ka pranuar prapësimin e të paditurit për “gjë të gjykuar”.

⁶⁴ vendimin nr. ***, datë 24.5.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; vendimin nr. ***, datë 29.10.2019, të Gjykatës së Apelit Vlorë; vendimin nr. ***, datë 18.4.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (ku është shënuar edhe vendimmarrja e gjykatave më të larta); vendimin nr. ***, datë 10.2.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (ku është shënuar edhe vendimmarrja e gjykatave më të larta); dhe vendimin nr. ***, datë 9.9.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (ku është shënuar edhe vendimmarrja e gjykatave më të larta).

Për më tepër, në kushtet kur një vendim i mëparshëm gjyqësor i formës së prerë ka disponuar se paditësi/denoncuesi, S.B, duhet të njohë pronarë të paditurit mbi sipërfaqen e truallit, vendimi i padisë në gjykim, në eventualitetin e pranimit të saj, do të detyronte tashmë të paditurit që të njihnin paditësin/denoncuesin, S.B, pronar mbi të njëjtin send, gjë që ndalohet kategorikisht nga neni 451/a i K.Pr.Civile.

Gjithashtu ka argumentuar se, proceduralisht, gjykata është e detyruar të vlerësojë prapësimin e të paditurit se padia përbën “gjë të gjykuar”, me qëllim shmangien e një gjykimi të dytë të njëjtë e të padobishëm.

d) në lidhje me përfundimin e Apelit se Gjykata e Shkallës së Parë ka gabuar që nuk ka marrë në shqyrtim kontratën e dhurimit nr. * regj., nr. *** kol., datë 10.8.1996:** neni 213 i K.Pr.Civile i jep të drejtë gjykatës që të marrë për shqyrtim vetëm ato prova që janë të domosdoshme e që kanë lidhje me çështjen në gjykim. Gjithsesi, gjykata ka arsyetuar se kjo provë (faqja 10 e vendimit nr.***, datë 24.5.2017) mund të shërbejë si shkak për rishikimin e vendimit të mëparshëm gjyqësor të formës së prerë, por në asnjë rast si provë për gjykimin e një padie, e cila vlerësohet si e njëjtë me një të mëparshme dhe të zgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, prapësimi të z. B se e kishte fituar pronësinë me këtë kontratë dhurimi, i ka dhënë përgjigje përfundimtare me vendimin nr. ***, datë 18.4.2005, duke e rrëzuar, me arsyetimin se ishte zgjidhur më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë. Ky vendim është lënë në fuqi në të gjitha shkallët e gjyqësorit.

Përveç sa më sipër, sipas tij, është tërësisht i pavërtetë edhe parashtrimi i bërë nga Gjykata e Apelit Vlorë se kontrata e dhurimit nr. *** regj., nr. *** kol., datë 10.8.1996, nuk ishte shqyrtuar asnjëherë si provë në gjykimet e mëparshme, pasi në gjykimin civil të përfunduar me vendimin ***, datë 10.12.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, denoncuesi S.B, në përgjigje të kërimit të paditësave për lirimin dhe dorëzimin e sipërfaqes së truallit (e cila ka qenë objekt edhe i gjyqësorit që kam zhvilluar subjekti), ka prapësuar se këtë sipërfaqe trualli e kishte përfunduar me kontratën e dhurimit nr.*** regj, nr. *** kol., datë 10.8.1996 (faqja 3 e vendimit nr. ***, datë 10.12.2007). Gjykata është shprehur lidhur me këtë prapësim, duke arsyetuar se atij i ishte dhënë përgjigje përfundimtare me vendimin nr. ***, datë 18.4.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (faqe 4 dhe 5 e vendimit nr. ***, datë 10.12.2007). Sikurse shihet, edhe në gjykimin e mëparshëm, pretendimi i denoncuesit S.B për pronësinë e fituar me kontratën e dhurimit, është rrëzuar me arsyetimin se ishte zgjidhur më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë. Ky vendim është lënë në fuqi në të gjitha shkallët e gjyqësorit.

e) në lidhje me përfundimin se Gjykata e Shkallës së Parë ka cenuar nenet 309 dhe 310 të K.Pr.Civile dhe se gjykata nuk i ka dhënë përgjigje prapësimeve të të paditurve: ky përfundim nuk qëndron, pasi siç vërehet edhe nga përmbajtja e vendimit, vendimmarrja është bazuar vetëm mbi provat në dosje, të analizuar dhe të vlerësuara sipas bindjes së brendshme të formuar nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të çështjes në tërësinë e tyre. Vendimi është i mirëarsyetuar dhe u është dhënë përgjigje të gjitha kërtimeve dhe prapësimeve të palëve ndërgjyqëse, duke argumentuar se të paditurit në këtë gjykim kanë paraqitur vetëm një prapësim dhe që lidhet me pretendimin se padia e paraqitur nga paditësi/denoncuesi, S.B, përbën “gjë të gjykuar”. Ky prapësim është shqyrtuar nga gjykata dhe mbi bazën e tij është vendosur rrëzimi i padisë.

Vlerësimi i Komisionit lidhur me këtë denoncim

58. Komisioni, pasi vlerësoi me objektivitet shpjegimet dhe provat e depozituara/të administruara, çmon se subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar në nivel ligjor dhe në mënyrë bindëse mbi gjetjet e kaluara me barrë prove bazuar në vendimin e Gjykatës së Apelit në shqyrtimin e çështjes objekt denoncimi, si edhe mbi pretendimet e ngritura nga denoncuesi, dhe si rrjedhojë nuk konstaton problematika thelbësore, të cilat do të ndikonin në vlerësimin e aftësive të tij profesionale. Trupi gjykues arrin në përfundimin se në shqyrtimin e kësaj çështjeje gjyqësore civile vendimi i gjyqësorit Taulant Banushi është marrë bazuar në bindjen e brendshme të tij, në interpretimin dhe analizimin e provave dhe ligjit të zbatueshëm.

Denoncimet e shtetas L.Z⁶⁵

59. Referuar këtyre ankesave Komisioni konstatoi se, ndër të tjerë, denoncohet edhe subjekti i rivlerësimit, për fakte dhe rrethana që lidhen me vendimin penal nr. ***, datë 3.2.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, nga ku rezulton se në shqyrtimin e çështjes për të cilën është dhënë vendimi i sipërcituar - pjesë e trupit gjykues ka qenë edhe gjyqtari Banushi.

59.1. Denoncuesja hedh dyshime se vendimmarrjet e gjyqtarëve, në bazë të të cilave është dënuar djali i saj, janë dhënë në shkelje të Kodit Penal dhe Kushtetutës, duke pretenduar se përveç shkeljeve ligjore, ka pasur shpërdorim detyre nëpërmjet manipulimit të dosjes dhe provave. Gjithashtu, ka pretenduar se seancat gjyqësore janë zhvilluar pa audio dhe se nuk është mundësuar thirrja dhe pyetja e një dëshmitari, për të cilin referon se roli dhe dëshmia e tij do ishte kyçe për zbardhjen e çështjes.

59.2. Nga verifikimi materialeve të dërguara bashkëlidhur ankesave rezulton se Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 1.7.2014, ka vendosur: prishjen e vendimit nr. ***, datë 3.4.2014, të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

59.3. Nga administrimi i akteve⁶⁶ të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe Gjykatës së Apelit Vlorë konstatohet se:

i) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier (në përbërje të trupit gjykues të së cilës si anëtar është subjekti i rivlerësimit, z. Taulant Banushi) në datën 3.2.2014, ka vendosur⁶⁷: (i) të deklarojë fajtor të pandehurin O.T për veprën penale “vrasje në rrethana cilësuese” dhe në bazë të nenit 79/dh të Kodit Penal, ta dënojë me 25 vjet burgim; (ii) të deklarojë fajtor të pandehurin O.T për veprën penale “Prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit” dhe në bazë të nenit 278/2 të Kodit Penal, ta dënojë me 2 vjet burgim; (iii) në bashkim të dënimeve, në bazë të nenit 55/1, 2 të Kodit Penal, ta dënojë përfundimisht të pandehurin, O.T, me 25 vjet burgim;

ii) pas ankimit të bërë nga i pandehuri O.T, Gjykata e Apelit Vlorë, në datën 1.7.2014, ka vendosur⁶⁸: prishjen e vendimit nr. ***, datë 3.2.2014, të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, dhe kthimin e akteve për rishqyrtim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

59.4. Komisioni vëren në mënyrë të përmbledhur se Gjykata e Apelit: i) ka caktuar mbrojtës kryesisht në këtë fazë gjykimi; ii) ka vlerësuar kryerjen e një aktekspertimi psikiatriko-ligjor për të përcaktuar gjendjen e shëndetit mendor të tij, përgjegjshmërinë për veprën e kryer, si edhe përcaktimin e gjendjes psikike të tij në çastin e kryerjes së vrasjes, nga i cili ka rezultuar se i pandehuri vuan nga çrregullimi psikotik i paspecificuar, nën ndikimin e të cilit ka kryer veprën penale; iii) veç sa më sipër, sipas Gjykatës së Apelit, nga aktet e gjykimit të çështjes në shkallë të parë rezulton se ajo gjykatë nuk ka siguruar mbrojtje reale të interesave të të pandehurit. Si përfundim, Gjykata e Apelit ka vlerësuar se sipas nenit 428, pika 1, germa “ç”, të K.Pr..Penale, shkelje të tilla çojnë në prishjen e vendimit dhe dërgimin e akteve për rigjykim në shkallën e parë.

59.5. Me dërgimin e rezultateve të hetimit administrativ, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të paraqesi shpjegimet/sqarimet/argumentet e tij mbi pretendimet e ngritura nga denoncuesi, si edhe për rrethanat e relatuara si më sipër, në referim të të cilave rezulton se Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier dhe kthimin e akteve për rishqyrtim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues, për shkelje të natyrës procedurale.

⁶⁵ Ankesa me nr. *** prot., datë 12.4.2018 dhe ankesa me nr. *** prot., datë 23.1.2019.

⁶⁶ Aktet e dosjes penale me nr. ***, datë 3.2.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, bashkë me dosjen hetimore me nr. ***, datë 28.7.2012; vendimin penal nr. ***, datë 3.2.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; aktet e dosjes penale nr. ***, datë 1.7.2014, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

⁶⁷ Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, nr.***, datë 3.2.2014.

⁶⁸ Vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë, nr. ***, datë 1.7.2014.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

60. Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar në mënyrë të detajuar argumentet e tij, duke depozituar si prova⁶⁹ në mbështetje të shpjegimeve të dhëna:

i) në lidhje me pretendimet e denoncueses subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se: a) qëndron pretendimi i denoncueses për moszhvillimin e seancave gjyqësore me audio, por kjo sepse çështja penale ka filluar të shqyrtohet 10 muaj përpara se të ishte instaluar sistemi i regjistrimit audio të seancave gjyqësore dhe sipas urdhrin përkatës të Kryetarit të Gjykatës, ato janë pasqyruar në procesverbalin e shkruajtur nga sekretarja e seancës; b) në lidhje me mosmarrjen në pyetje të dëshmitarit: siç rezulton edhe nga aktet në dosjen penale, gjykata, në kushtet kur edhe pasi ka lëshuar urdhër për shoqërimin e detyrueshëm të shtetasit A.M, e ka pasur të pamundur marrjen e tij në pyetje, pasi, ky shtetas, sipas sistemit *TIMS*, rezulton të ishte jashtë vendit, pa adresë të ditur dhe në bazë të nenit 369/3 të K.Pr.Penale, gjykata ka lejuar leximin e deklarimeve të bëra prej tij në fazën e hetimit paraprak, duke e bashkuar këtë procesverbal me fashikullin e gjykimit në procesverbalin e seancës gjyqësore.

ii) në lidhje me përfundimet e arritura nga Gjykata e Apelit Vlorë, ka parashtruar sa vijon:

a) **në lidhje me problemet e shëndetit mendor:** sikurse rezulton edhe nga procesverbalet e gjykatës, nuk ka rezultuar që i pandehuri të ketë shfaqur probleme mendore. Ai ka komunikuar normalisht me gjykatën, ka qenë në gjendje të japë versionin e tij të ngjarjes, si dhe të kundërshtonte deklaratimet e bëra në fazën e hetimit paraprak nga shtetasi A.M, të cilat u administruan gjatë gjykimit. Ka qenë i orientuar në hapësirë dhe në kohë dhe ka artikuluar normalisht fjalitë që thoshte, pavarësisht mënyrës dhe cilësisë së artikulimit, e cila lidhej edhe me nivelin e tij të inteligjencës. Gjithashtu, nuk ka rezultuar të ketë pasur në fashikullin e prokurorit ndonjë akt që tregonte për probleme të shëndetit mendor. Për më tepër, fakti që i pandehuri nuk ka pasur probleme të tilla është provuar në gjykimet e mëpasshme. Pas kthimit të çështjes për rigjykim⁷⁰ pjesë e së cilës është edhe aktekspertimi që vërteton se i pandehuri nuk vuan nga ndonjë çrregullim psikik, Gjykata ka vendosur dënimin e tij përfundimisht me 25 vjet burgim.

Në vijim, subjekti ka shpjeguar Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 10.11.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 24.7.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 15.12.2016, ka vendosur mospranimin e rekursit ndaj vendimit nr. ***, datë 10.11.2015, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Për sa më sipër, subjekti ka argumentuar se gjykimi i mëpasshëm i çështjes penale në ngarkim të të pandehurit, O.T, ka provuar drejtësinë e vendimit të marrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, në përbërje të të cilës ka qenë edhe ai si gjyqtar, jo vetëm në lidhje me deklarinin fajtor për kryerjen e veprave penale për të cilat është akuzuar dhe masën e dënimit të caktuar, por edhe në lidhje me gjendjen e shëndetit mendor të këtij të pandehuri.

b) **Subjekti ka argumentuar se nuk është i drejtë përfundimi i arritur nga Gjykata e Apelit për mungesën e sigurimit të mbrojtjes efektive për të pandehurin O.T,** pasi: i) gjykata ka siguruar në çdo seancë avokat të siguruar kryesisht; ii) vetë i pandehuri ka kërkuar në disa seanca të mos mbrohet nga avokati, madje ka kërkuar përjashtimin e tij; iii) në kohën e zhvillimit të këtij gjykimi, ligji procedural nuk parashikonte mbrojtje të detyrueshme për të pandehurin, edhe kundër

⁶⁹ Procesverbalin e seancës gjyqësore në çështjen penale në ngarkim të të pandehurit O.T; aktet për njoftimin e dëshmitarit A. M; urdhrin e Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier nr. *** prot, datë 30.9.2013 “Për aplikimin e sistemit të regjistrimit audio”; vendimin nr. ***, datë 3.2.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; vendimin nr. ***, datë 1.7.2014, të Gjykatës së Apelit Vlorë; vendimin nr. ***, datë 24.7.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; vendimin nr. ***, datë 3.2.2014, të Gjykatës së Apelit Vlorë; dhe vendimin nr. ***, datë 15.12.2016, të Gjykatës së Lartë.

⁷⁰ Me vendimin nr. ***, datë 24.7.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, është vendosur deklarimi fajtor i pandehurit O.T.

dëshirës së tij, sikurse ndodhi me ndryshimet e bëra në K.Pr.Penale me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017, ku parashikohet mbrojtja e detyrueshme në gjykimet e çështjeve për një kategori të caktuar veprash penale; iv) Gjykata e Apelit përtej konstatimit, nuk referon se çfarë veprimesh duhet të kryente Gjykata e Shkallës së Parë iv) Gjykata e Apelit ka konsideruar joefektive mbrojtjen e të pandehur nisur nga prezumimi se ai vuante nga çrregullime mendore, gjë që nuk rezultoi e vërtetë. Nëse vlerësimi bëhet nisur nga këto fakte të provuara, rezulton se Gjykata e Shkallës së Parë nuk ka cenuar asnjë dispozitë procedurale që lidhet me ushtrimin e ndjekjes penale dhe mbrojtjen e të pandehurit.

Vlerësimi i Komisionit lidhur me këtë denoncim

61. Nga verifikimi i akteve të kësaj dosjeje gjyqësore penale, si përfundim nuk ka rezultuar që i pandehuri para se të kryente veprën penale dhe/apo gjatë kryerjes së saj: i) të vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik, i tillë që të ketë prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe për pasojë ai të mos ketë qenë në gjendje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se kryen vepër penale, çka do të përbënte shkak për shmangien e tij nga përgjegjësia penale, sipas parashikimeve të nenit 17 të Kodit Penal; ii) nuk ka pasur pretendime prej mbrojtësve ligjorë lidhur me këtë rrethanë, në gjykimin në shkallë të parë (para rigjyimit); iii) gjykata nuk ka konstatuar sjellje gjatë gjyimit që vinin në dyshim shëndetin mendor dhe të urdhëronte aktekspertimin dhe nuk u provuan as kushtet e parashikuara në pikën 1 të nenit 43 të Kodit të Procedurës Penale; iv) nuk rezulton që organi i akuzës të ketë pasur nevojë për përcaktimin e përgjegjshmërisë, sipas pikës 3 të nenit 43 të Kodit të Procedurës Penale.

61.1. Parë në këtë këndvështrim, duket se prishja e vendimit nga Gjykata e Apelit nuk është rrjedhojë e moszbatimit të drejtpërdrejtë e dispozitave procedurale nga Gjykata e Shkallës së Parë, pasi rezulton se gjykata e ka marrë vendimin bazuar në bindjen e brendshme në analizë të akteve, të dhënave dhe rrethanave të ndodhura gjatë gjyimit, nga të cilat nuk rezultoi mundësia që i pandehuri të kishte probleme të shëndetit mendor dhe për më tepër konstatohet se Gjykata ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të siguruar mbrojtjen efektive të të pandehurit.

61.2. Si përfundim, Komisioni, pasi vlerësoi me objektivitet shpjegimet dhe provat e depozituara/të administruara, çmon se subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar në nivel ligjor dhe në mënyrë bindëse mbi gjetjet e relatuar që lidhen me përfundimet e nxjerra nga Gjykata e Apelit në shqyrtimin e çështjes objekt denoncimi, si edhe mbi pretendimet e ngritura nga denoncuesi, dhe si rrjedhim nuk konstaton problematika, të cilat do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale.

Denoncimi i përmbauesit gjyqësor privat, z. A.V⁷¹

62. Nga verifikimi i kësaj ankese, Komisioni konstaton se denoncuesi ngre pretendime lidhur me vendimin e marrë në datën 27.9.2021, nga gjyqtari Banushi⁷², që lidhet me çështjen me palë ndërgjyqëse: palë paditëse, shoqëria “***” sh.a., palë e paditur përmbauesi gjyqësor privat, A.V; me objekt: «1). *Kundërshtimi i veprimeve të përmbauesit gjyqësor, shkresës me nr. *** prot., datë 6.7.2021, “Për vënien e masës së sekuestros konservative ndaj personit të tretë dhe shkresës me nr. *** prot., datë 13.7.2021 “Urdhër për vënien e sekuestros ekzekutive”, ndaj personit të tretë. 2). Pezullimin e ekzekutimit të vendimit.»*

62.1. Denoncuesi pretendon se qëndrimi i gjykatës nga fillimi deri në fund të shqyrtimit të çështjes ka qenë i njëanshëm, i qëllimshëm, duke dhënë një vendim krejtësisht në kundërshtim me ligjin, të pabazuar në prova dhe absurd, i cili *de facto* lë në fuqi sekuestron konservative të përmbauesit gjyqësor, por duke u shprehur për mosekzekutimin e saj, ndërkohë që urdhri për transferimin e shumës në fakt është një veprim procedural, i cili është pasojë ligjore e sekuestros konservative, pasi nuk mund të konfirmohet ngirja e balancës sipas sekuestros konservative dhe të mos lejohet transferimi i kësaj shume.

⁷¹ Ankesa me nr. *** prot., datë 14.10.2021.

⁷² Vendmi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me nr. *** , datë 27.9.2021.

62.2. Në mënyrë të përmbledhur, pretendimet e denoncuesit, pasqyrohen si më poshtë vijon:

i) gjykata e ka zhvilluar gjykimin pa njoftuar palët në proces dhe ka marrë në shqyrtim vetëm kërkesëpadinë e palës paditëse, duke u bërë edhe avokat i saj; ii) gjykata edhe pse ka konstatuar se kërkesa nuk është ngritur në formën e kërkuar nga ligji, nuk ka kthyer aktet dhe të orientojë palën për rregullimin e formës së paraqitjes së ankimit në gjykatë, por ka nisur në mënyrë të paligjshme një proces gjyqësor, duke transformuar me vetëdije dhe me dashje formën dhe procedurën e parashikuar nga Kodi i Procedurës Civile; iii) gjykata nuk ka respektuar parimet e neneve 442/a dhe 610 të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se çdo veprim përmbartimor është akt më vete dhe gjykohet si i tillë; iv) gjykata ka vepruar në tejkalim të kërkesave të paditësit, si dhe ankimi nuk është shqyrtuar brenda afatit 20-ditor, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile; v) gjykata nuk ka konstatuar mangësitë thelbësore në ndërgjyqësinë, në të cilën nuk ishte thirrur pala kreditore, duke i mohuar asaj të drejtën e përfaqësimit dhe mbrojtjes.

62.3. Sipas denoncuesit, vendimmarrja e këtij trupi gjykues, i përbërë nga gjyqtari i vetëm, z. Taulant Banushi, ka cenuar një sërë parashikimesh themelore të procedurës civile, të listuara sa më poshtë vijon: (i) Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet; (ii) gjykata mbështet vendimin e saj vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor; (iii) gjykata ka për detyrë që të zhvillojë një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë e të gjithanshëm, në përputhje me ligjin; (iv) gjykata nuk mund të ndryshojë bazën juridike të padisë pa kërkesën e palës; (v) gjykata duhet të ndjekë dhe të kërkojë të zbatohet parimi i kontradiktoritetit. Ajo e mbështet vendimin e saj vetëm në mjetet, shpjegimet, dokumentet dhe provat e tjera të treguara ose të sjella nga palët, kur këto të fundit kanë qenë në gjendje të debatojnë sipas parimit të kontradiktoritetit; (vi) gjykata duhet të shprehet për të gjitha kërkesat që parashtrihen në padi, duke realizuar një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm, brenda këtij afati të arsyeshëm; dhe (vii) gjykata e mbështet vendimin në provat e paraqitura nga palët ose nga prokurori, të marra në seancë gjyqësore.

62.4. Me dërgimin e rezultateve të hetimit administrativ, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të japi shpjegimet/sqarimet/argumentet e tij mbi këtë denoncim, për pretendimet e denoncuesit, si dhe të provojë me dokumente justifikuese veprimet e kryera prej tij gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

63. Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, mbi pretendimet e ngritura në këtë denoncim, gjetjet e relatuar dhe kërkesat e bëra nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar në mënyrë të detajuar argumentet e tij, duke depozituar prova⁷³ në mbështetje të shpjegimeve të dhëna.

63.1. Komisioni vëren se në prapësimet e tij subjekti i rivlerësimit fillimisht ka referuar vendimmarrjet e gjykatave që lidhen çështjen objekt denoncimi, duke konstatuar se: **i)** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, e përbërë nga gjyqtari Taulant Banushi, me vendimin nr. ***, datë 27.9.2021, ka vendosur: pranimin pjesërisht të ankimit të shoqërisë “****” sh.a.; anulimin e urdhrit nr. ***, datë 12.7.2021, të përmbartuesit gjyqësor privat, A.V, për vënien e sekuestros ekzekutive mbi llogaritë e shoqërisë “****” sh.a.; rrëzimin e ankimit për pjesën ku është kërkuar kundërshtimi i urdhrit nr. ***, datë 6.7.2021, të përmbartuesit gjyqësor privat, A.V, për vënien e sekuestros konservative mbi llogaritë e shoqërisë “****” sh.a; **ii)** Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 07.12.2021,

⁷³ Kopje të akteve që tregojnë veprimet e gjykatës në gjykimin e kësaj çështjeje, të nxjerra nga dosja gjyqësore dhe me vulën e Gjykatës së Apelit Vlorë (duke qenë se dosja ndodhet ende në këtë gjykatë); vendimin për pezullimin e ekzekutimit dhe atë perfundimtar të marrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier; vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë, e cila ka shqyrtuar vendimin për pezullimin e ekzekutimit të gjykatës së shkallës së parë; dispozitivin e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë mbi themelin e çështjes, me vulën e kësaj gjykate (duke qenë se vendimi nuk është zbardhur ende); dhe urdhrin e Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për planifikimin e gjyqtarëve për shqyrtimin e masave të sigurimit në periudhën e lejes së zakonshme, në muajin gusht 2021.

ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 27.9.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, duke sqaruar se vendimi i gjykatës së apelit nuk është arsyetuar ende (subjekti ka vënë në dispozicion dispozitivin e tij, të nxjerrë nga sistemi dhe të vulosur nga Gjykata e Apelit Vlorë); **iii)** Gjatë gjykimit të kësaj çështjeje, gjykata, me vendimin e datë 27.7.2021, ka vendosur: pranimin e kërkesës; pezullimin e veprimeve përmbarimore të përmbaruesit gjyqësor privat, A.V, ndaj shoqërisë “****” sh.a., Patos, në procedurat përmbarimore të ekzekutimit të detyrueshëm, të regjistruara me kërkesën e kreditorëve shoqëria “****” sh.p.k., Sh.P, O.P, G.P, M.P, shoqëria “****” sh.p.k., shoqëria “****” sh.a., shoqëria “****” sh.a., shoqëria “****” sh.p.k., shoqëria “****” sh.p.k., shoqëria “****” sh.p.k., Ç.H dhe A.Z, kundër debitorit shoqëria “****”; **iv)** Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 03.11.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të ndërmjetëm të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, të datës 27.7.2021, për pezullimin e veprimeve përmbarimore të përmbaruesit gjyqësor privat, A.V, ndaj shoqërisë “****” sh.a., në çështjen me nr. *** akti.

63.2. Në lidhje me pretendimet e ngritura nga denoncuesi, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar sa vijon:

i) për pretendimin e zhvillimit të procesit pa njoftuar palët: pavarësisht nenit 610 të Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se kërkesa për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore shqyrtohet brenda 20 ditëve nga gjykata e vendit të ekzekutimit, e cila kur e sheh të nevojshme mund të thërrasë edhe palët dhe përmbaruesin gjyqësor, ka vlerësuar të nevojshme thirrjen e palëve. Për shkak të kohës së shkurtër në dispozicion për njoftim, zoti V është njoftuar në numrin e telefonit të pasqyruar nga vetë ky i fundit në aktet që ndodheshin në dosjen gjyqësore dhe që ishin të nxjerra prej tij.

Veprimi i njoftimit të përmbaruesit gjyqësor privat A.V është pasqyruar edhe në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim nga nëpunësi gjyqësor i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, F.F (procesverbal i cili është paraqitur Komisionit në cilësinë e provës), por përmbaruesi nuk është paraqitur në seancë gjyqësore dhe gjykata ka vazhduar gjykimin pa praninë e tij dhe ka vendosur pezullimin e veprimeve përmbarimore. Vendimi i është njoftuar përmbaruesit, i cili ka ushtruar të drejtën e ankimit dhe sikundër është parashtruar më sipër, Gjykata e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të këtij vendimi. Nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës së Apelit rezulton se apeluesi ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e kërkesës dhe nuk ka paraqitur pretendime në lidhje me njoftimin;

ii) lidhur me pretendimin se gjykata nuk ka orientuar palët për formën e duhur të ankimit, por ka vazhduar me gjykimin: a) paraqitja e ankimit në formën e një kërkesëpadie nuk mund të përbejë shkak për kthimin e akteve dhe aq më pak për mosshqyrtimin e tij; b) në rastin në gjykim, kërkesëpadia e paraqitur nga shoqëria “****” sh.a., i ka plotësuar të gjitha kushtet e përmendura në nenet 154 dhe 156 të K.Pr.Civile dhe gjykata nuk mund t’i kthente aktet. Forma e aktit me të cilin pala i drejtohet gjykatës, nuk parashikohet nga ligji si një nga elementet, mungesa e të cilit detyron gjykatën që të kërkojë plotësimin e të metave të padisë, në kuptim të nenit 154/a të K.Pr.Civile.

Në rastin e parashikuar nga neni 610 i K.Pr.Civile, paraqitja e një ankimi, pavarësisht formës së tij, detyron gjykatën që ta shqyrtojë atë dhe të japë vendim në lidhje me ligjshmërinë e veprimit të përmbaruesit gjyqësor. Pavarësisht se është hartuar formalisht si kërkesëpadi, akti që ka vënë në lëvizje gjykatën ka plotësuar standartin për t’u konsideruar formalisht si ankim kundër veprimit të përmbaruesit gjyqësor dhe për këtë arsye gjykata e ka marrë për shqyrtim dhe i ka dhënë përgjigje me vendim përfundimtar. Gjykata ka arsyetuar edhe në lidhje me këtë moment në vendimin përfundimtar, të cilit i qëndron plotësisht.

Si përfundim, lidhur me këtë pretendim, subjekti ka parashtruar se, në këtë rast, jo vetëm që nuk ka transformuar procedurën, sikurse ka pretenduar denoncuesi, por e ka zbatuar dhe respektuar me rigorozitet. Akti është trajtuar dhe shqyrtuar si kërkesë ankimore, ashtu sikurse parashikon neni 610 i K.Pr.Civile.

iii) në lidhje me pretendimin se Gjykata duhet të kthente aktet dhe të orientonte palët se çdo veprim përbarimor është një akt më vete dhe si i tillë kundërshtohet dhe gjykohet veçmas: kundërshtimi i dy veprime përbarimore në të njëjtën kërkesë, nuk përbën të metë të kërkesës, në kuptim të nenit 154/a të K.Pr.Civile, në mënyrë që gjykata të merrte vendimin për plotësimin e të metave ose kthimin e akteve. Nuk ka asnjë parashikim ligjor që ndalon paraqitjen e ankimit njëkohësisht ndaj dy ose më shumë veprimeve përbarimore. I vetmi kusht që ka vënë ligji (neni 610 i K.Pr.Civile) është respektimi i afatit për paraqitjen e kërkesës në raport me kohën e kryerjes së veprimit apo marrjes dijeni për të. Për sa më sipër, edhe në këtë rast, subjekti deklaroi se ka vepruar në përputhje të plotë me nenet 610 dhe 442/a të Kodit të Procedurës Civile;

iv) lidhur me pretendimin se gjykata gjykata ka vepruar në tejkalim të kërkesave të paditësit, ka ndryshuar bazën ligjore, si dhe ankimi nuk është shqyrtuar brenda afatit 20-ditor, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile, subjekti ka shpjeguar se përbaruesi ngatërron bazën juridike të padisë me shkakun ligjor të saj, të cilat janë të ndryshme nga njëra-tjetra;

v) lidhur me pretendimin se në nenin 16 të K.Pr.Civile parashikohet se “Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët. Megjithatë, gjykata nuk mund të ndryshojë bazën juridike të padisë pa kërkesën e palës”.

Në rastin në gjykim, gjykata ka identifikuar shkakun ligjor të kërkesës dhe ka bërë cilësimin e fakteve dhe veprimeve përbarimore objekt kundërshtimi, sipas neneve 581, 583, 584, 585 dhe 610 të K.Pr.Civile.

Shoqëria “****” sh.a., ka kundërshtuar veprimet e përbaruesit gjyqësor privat, A.V, duke pretenduar se është vendosur gabimisht në cilësinë e personit të tretë në disa procedura ekzekutimi, pasi vetë kjo shoqëri është në cilësinë e kreditorit ndaj shoqërisë “****”, në një vlerë më të madhe se ajo e përcaktuar në vendimin e arbitrazhit. Mbi bazën e këtij pretendimi, si dhe duke iu referuar veprimeve konkrete të kryera nga përbaruesi, gjykata ka bërë cilësimin e tyre, duke iu referuar neneve 581, 583, 584 dhe 585 të K.Pr.Civile, të cilat parashikojnë procedurën që duhet të ndiqet në rastin kur ekzekutimi kryhet mbi sende apo kredi që personi i tretë i detyrohet debitorit.

Pra, në përfundim të arsyetimit të tij lidhur me këtë pretendim, subjekti parashtron se në këtë rast ka vepruar në përputhje të plotë me nenin 16 të Kodit të Procedurës Civile. Ndërsa, në lidhje me zgjidhjen në themel të çështjes vlerëson që e ka zgjidhur në përputhje me ligjin, ndërkohë që kontrolli i vendimmarrjes është realizuar tashmë edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë, e cila ka lënë fuqi vendimin e marrë prej tij.

vi) në lidhje me pretendimin se gjykimi nuk ka përfunduar brenda afatit 20-ditor, të parashikuar nga neni 610 i K.Pr.Civile, deklaroi se ky pretendim është i vërtetë, por kanë qenë pikërisht veprimet e denoncuesit, A.V, ato që janë bërë shkak për mosrespektimin e këtij afati.

Kështu, subjekti ka shpjeguar se çështja është regjistruar në gjykatë më 19.7.2021 dhe ka përfunduar më 27.9.2021, duke zgjatur gjithsej 70 ditë kalendarike, duke përfshirë këtu midis të tjerash edhe lejen e zakonshme vjetore, e detyrueshme për t’u marrë në gusht nga gjyqtarët. Siç vërehet edhe nga procesverbali në dosje, përbaruesi privat nuk është paraqitur në seancën e datës 27.7.2021, pa shkaqe të përligjura dhe më pas në seancën e datës 9.9.2021 avokati i tij ka kërkuar shtyrjen e seancës për t’u njohur me aktet në dosje, por nuk është paraqitur në seancën e datës 14.9.2021, për shkaqe shëndetësore, të vërtetuara me raport mjekësor.

Në seancën gjyqësore të datës 21.9.2021, e cila ka qenë plotësisht efektive, gjykata ka zhvilluar të gjithë procedurën e gjykimit, duke përfshirë edhe diskutimin përfundimtar të palëve ndërgjyqëse, ndërkohë që ka shtyrë shpalljen e arsytuar tij, për shkak se e ka pasur të pamundur marrjen e vendimit brenda asaj seance, edhe për faktin se një pjesë e rëndësishme e provave u paraqitën nga i padituri pikërisht në këtë seancë gjyqësore. Seanca është shtyrë për në datën 27.9.2021.

Në seancën gjyqësore të datës 27.9.2021, gjykata ka shpallur vendimin përfundimtar, duke përfunduar gjykimin e çështjes.

Për sa më sipër, subjekti ka argumentuar se sikurse shihet 12 ditë kalendarike, të cilat i përkasin periudhës nga seanca gjyqësore e datës 9.9.2021 deri në seancën gjyqësore të datës 21.9.2021, janë shtyrë me kërkesën e vetë denoncuesit. Nëse denoncuesi do të kishte marrë masat për të siguruar mbrojtjen dhe njohjen me aktet brenda afatit të caktuar nga gjykata, gjykimi do të kishte përfunduar në afatin e përcaktuar nga ligji.

Për sa më sipër, në përfundim të prapësimeve të tij lidhur me këtë pretendim të ngritur nga denoncuesi, subjekti ka parashtruar se në këtë rast nuk rezulton të ketë ndonjë veprim apo mosveprim nga gjykata, i cili të ketë sjellë si pasojë mospërfundimin e gjykimit brenda afatit 20-ditor;

vii) lidhur me pretendimin e denoncuesit për mosformimin e drejtë të ndërgjygjësisë, subjekti rivlerësimi ka argumentuar se gjykata nuk ka vlerësuar të nevojshme thirrjen e kreditorëve, pasi objekti i gjykimit kanë qenë veprimet e përmbaruesit gjyqësor ndaj shoqërisë “****” sh.a., të cilën përmbaruesi e ka konsideruar si person të tretë në ekzekutim, ndërkohë që nga përmbajtja e urdhrave që kundërshtoheshin, ka rezultuar se kjo shoqëri ka qenë njëri prej kreditorëve. Sipas subjektit, ajo që çon në kufirin e absurditetit këtë pretendim/denoncim, është fakti se vetë denoncuesi, në kundërshtim flagrant me ligjin, nuk i kishte vënë në dijeni kreditorët për veprimin që ishte duke kryer.

Vlerësimi i Komisionit për këtë denoncim

64. Komisioni, pasi vlerësoi me objektivitet shpjegimet dhe provat e depozituara lidhur me çështjen objekt denoncimi, çmon se subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar në nivel ligjor dhe në mënyrë bindëse mbi pretendimet e ngritura në këtë denoncim dhe se nuk konstatohen problematika thelbësore, të cilat do të mund të ndikojnë në vlerësimin e aftësive të tij profesionale.

Shqyrtimi dhe analizimi i 5 (pesë) dosjeve të tjera gjyqësore

65. Gjithashtu, në funksion të verifikimit të informacioneve/sinjalizimeve të përfuara nga institucionet e verifikimit, Komisioni administroi⁷⁴ dhe analizoi dosjet e 5 (pesë) çështjeve gjyqësore, nga të cilat 3 (tri) çështje penale dhe 2 (dy) çështje civile, të raportuara si të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, z. Taulant Banushi, në cilësinë e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

65.1. Trupi gjykues analizoi me objektivitet çështjet penale me të pandehur shtetasin Gj.Xh⁷⁵, akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Vjedhje e bankave dhe arkave të kursimit” me pasoja të rënda dhe “Falsifikimi i dokumenteve” më shumë se një herë, parashikuar nga nenet 136/2 dhe 186/2, të Kodit Penal; çështjen penale me të pandehur shtetasit, H.Gj, V.Xh, V.N, G.K, Dh.Ç⁷⁶, akuzuar për veprën penale të “Shpërdorim detyre”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 e 25 të Kodit Penal dhe shtetasit Sh. R, akuzuar për veprën penale të “Mashtrimit”, parashikuar nga neni 143/2, i Kodit Penal, si dhe çështjen civile me palë shtetasen M.Gj; të paditur: shtetasit S.P, L.G, etj.; me objekt: “Pjesëtimi i sendit të përbashkët në pasurinë e familjes bujqësore...” për të cilën **Gjykata e Apelit Vlorë**, në datën 13.11.2019, ka vendosur⁷⁷: lënien në fuqi të vendimit nr.*** datë 2.6.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

⁷⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 7.2.2022 dhe kthim përgjigjja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me nr. *** prot., datë 17.2.2022 (protokolluar me nr. *** prot., datë 21.2.2022).

⁷⁵ Dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me shkresën nr. ***prot., datë 17.2.2021.

⁷⁶ Dërguar me të njëjtën shkresë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

⁷⁷ Vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë me nr. *** , datë 13.11.2019.

65.2. Pas verifikimit dhe analizimit të këtyre dosjeve gjyqësore penale dhe civile dhe akteve pjesë përbërëse të tyre, trupi gjykues vëren se nuk ekzistojnë të dhëna/fakte dhe/apo rrethana, të tilla që, të përbënin prova për gjetje mbi bazën e të cilave do mund të vlerësohej veprimtaria e subjektit të rivlerësimit, gjyqtarit Taulant Banushi, për aspekte që lidhen me vlerësimin e kriterit etiko – profesional.

Çështja penale me të pandehur shtetasit T.S dhe E.K

66. Nga verifikimi i dosjes gjyqësore⁷⁸, që i përket çështjes penale me të pandehur shtetasit T.S dhe E.K, akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal, konstatohet se:

i. Mbas hetimeve të kryera, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier ka dërguar për gjykim⁷⁹ çështjen në ngarkim të këtyre dy shtetasve, dhe si përfundim ka kërkuar deklarin fajtor të të pandehurve T.S dhe E.K, për kryerjen e veprës penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2 të Kodit Penal dhe dënimin e secilit me 7 vjet burgim, duke sugjeruar që në masën e dënimit të aplikohet neni 406/1 i K.Pr.Penale, pra, ulja e dënimit me 1/3.

ii. Mbrojtësit ligjorë të dy të pandehurve, kërkuar rikualifikimin ligjor të veprës penale, nga ajo e “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2, i Kodit Penal, në atë të parashikuar nga neni 283/1 të Kodit Penal, aplikimin e nenit 406/1 të K.Pr.Penale, uljen me 1/3 e dënimit dhe aplikimin e nenit 59 të K.Pr.Penale, pezullimin e dënimit me burgim dhe vënien në provë të të pandehurëve.

iii. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, në përbërje të trupit gjykues të së cilës, si anëtar është edhe subjekti i rivlerësimit, z. Taulant Banushi, në datën 23.4.2012, ka vendosur⁸⁰: deklarin fajtor të të pandehurve T.S dhe E.K, për veprën penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve” dhe në bazë të nenit 283/1 të Kodit Penal; dënimin e secilit me nga 5 vjet burgim. Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale i ka zbritur 1/3 e dënimit secilit të pandehur, dhe si rrjedhojë atyre u ngelet për të vuajtur një dënim me burg prej 3 (tre) vjet e 4 (katër) muaj, secilit.

Në arsyetimin e këtij vendimi është parashtruar se në bazë të nenit 375 të K.Pr.Penale, me vendimin përfundimtar gjykata i jep faktit penal të mësipërm (të analizuar gjatë vendimit) një përcaktim të ndryshëm nga prokurori, duke konkluduar se të pandehurit kanë konsumuar veprën penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, në formën e mbajtjes, të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe jo atë të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal, për të cilën janë akuzuar nga organi i prokurorisë. Në analizë të veprimeve të të pandehurve, si dhe mekanizmit të ngjarjes (të shpjeguar në vendim) gjykata ka çmuar se mungon bashkëpunimi midis dy të pandehurve në kryerjen e veprës penale të mësipërme.

iv. Kundër këtij vendimi penal ka ushtruar ankim Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier⁸¹, por edhe të pandehurit. Rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier ka kërkuar prishjen e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, gjykimin e çështjes në fakt dhe deklarin fajtor dhe dënimin e të pandehurve T.S dhe E.K, sipas kërkesës së bërë nga ana e tyre. Nga ana tjetër, të pandehurit kanë kërkuar ndryshimin pjesërisht të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke kërkuar konkretisht aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, pra pezullimin e ekzikutimit të pjesës së mbetur të dënimit dhe vënien e tyre në provë.

Në vijim, konstatohet se në datën 15.7.2014, prokurori P.M., përfaqësues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, ka bërë deklaratën për heqje dorë nga ankimi. Referuar kësaj deklarate, përfaqësuesi i prokurorisë ka vlerësuar se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është i drejtë dhe i bazuar në prova dhe në ligj dhe për këtë shkak, ankimi i prokurorit të seancës nuk duhet të

⁷⁸ Dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me shkresën nr. *** prot., datë 17.2.2021.

⁷⁹ Dërguar dosja për gjykim me shkresën e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, me nr. *** prot., datë 2.12.2013.

⁸⁰ Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me nr. *** datë 23.4.2014.

⁸¹ Dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 2.5.2014, ankimi kundër vendimit penal nr. *** , datë 23.4.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

përkrahet. Sipas tij, siç është arsyetuar në vendimin e gjykatës, të pandehurit e kanë poseduar lëndën narkotike veçmas njëri - tjetrit, pavarësisht se kanë qëndruar në të njëjtin vend.

v. Gjykata e Apelit Vlorë, më 15.7.2014, ka vendosur⁸²: lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 23.4.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me plotësimin: në zbatim të nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit për pjesën e pavuajtur për të pandehurit T.S dhe E.K, me kusht që të mos kryejnë vepër tjetër penale për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh.

Vlen të theksohet fakti se nga aktet e dosjes ka rezultuar se të pandehurit T.S i janë gjetur 18.10 gram lëndë narkotike e llojit *canabis sativa*, ndërsa të pandehurit E.K, i janë gjetur 2.35 gram lëndë narkotike e llojit *canabis sativa* dhe se nga ekspertimet e kryera për të dy këta shtetas, në mostrën e urinës është zbuluar prania e produkteve të metabolizmit të kanabinoideve (pra, duket se ata janë përdorues).

66.1. Sa më sipër, mbas verifikimit, shqyrtimit dhe analizimit të kësaj dosjeje gjyqësore penale dhe akteve pjesë përbërëse të saj, Komisioni vëren se nuk ekzistojnë të dhëna/fakte dhe/apo rrethana, të tilla që, të përbënin prova për gjetje mbi bazën e të cilave do mund të vlerësohej veprimtaria e subjektit të rivlerësimit, gjyqtarit Taulant Banushi, për aspekte që lidhen me vlerësimin e kriterit etiko – profesional.

Çështja civile me palë ndërgjyqëse: paditës: z. A. Y dhe e paditur: znj. M. Sh

67. Nga verifikimi i dosjes gjyqësore⁸³, që i përket çështjes civile me paditës: shtetasin A.Y; të paditur: shtetasen M.Sh; person i tretë: ALUIZNI Drejtoria Rajonale Fier; me objekt: “*Njohje bashkëpronarë në pasurinë objekt legalizimi në ALUIZNI Fier, në emër të shtetasen M.Sh, e përbërë nga 160 m2..*”, konstatohet se:

i) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, e përbërë nga gjyqtari i vetëm, z. Taulant Banushi, në datë 3.11.2017, ka vendosur⁸⁴: pranimin e padisë; detyrimin e së paditurës M.Sh të njohë paditësin A.Y bashkëpronar në objektin “ndërtesë” me sipërfaqe 157.9 m², i ndodhur në “****”, Fier, aktualisht në proces legalizimi.

ii) Pas ankimit të bërë nga pala e paditur, Gjykata e Apelit Vlorë, në datën 7.10.2020, për çështjen objekt shqyrtimi, ka vendosur⁸⁵: prishjen e vendimit nr. ***, datë 3.11.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe dërgimin e çështjes për rigjykim pranë së njëjtës gjykatë, por me trup tjetër gjykues.

67.1. Në arsyetimin e vendimit, Gjykata e Apelit Vlorë parashtron se Gjykata e Shkallës së Parë **nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë ligjin procedural** që ka të bëjë me përcaktimet e nenit 14, 16, 193, dhe 158/c, të Kodit të Procedurës Civile, për të dhënë një vendim të bazuar në ligj e në prova. Në këtë kuptim, Gjykata e Apelit ka çmuar se përfundimi i arritur nga Gjykata e Shkallës së Parë Fier është rrjedhojë e një hetimi jo të plotë e të gjithanshëm.

67.2. Gjithashtu, në këtë vendim, Gjykata e Apelit parashtron se Gjykata në rigjykim duhet t’u bëjë të ditur palëve në proces faktin se duhet të jetë palë në proces dhe shtetasi Sh.Y, dhe nëse nuk reagohej nga palët, gjykata duhet ta thërrasë në cilësinë e personit të tretë këtë shtetas, duke kërkuar prej tij dokumentacion dhe shpjegime lidhur me çështjen objekt shqyrtimi. Në rigjykim, Gjykata duhet të ketë në konsideratë që paditësi të përcaktojë saktë kërkimet në objektin e padisë dhe palët në proces.

⁸² Vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë me nr. ***, datë 15.7.2014.

⁸³ Dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me shkresën nr. *** prot., datë 17.2.2021.

⁸⁴ Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me nr. ***, datë 3.11.2017.

⁸⁵ Vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë me nr. ***, datë 7.10.2020.

67.3. Si përfundim, Gjykata e Apelit ka vlerësuar se çështja në shkallë të parë është gjykuar në **shkelje të rregullave procedurale që kanë të bëjnë me formimin e ndërgjyqjesisë** (sipas parashikimeve të bëra në nenin 467 të K.Pr.Civile) dhe për këtë arsye ka vendosur që çështja të kthehet për rigjykim pranë së njëjtës gjykatë, por me trup tjetër gjykues.

67.4. Me dërgimin e rezultateve të hetimit administrativ, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të japi shpjegimet/sqarimet/argumentet e tij për rrethanat e relatuara si më sipër.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

68. Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar në mënyrë të detajuar argumentet e tij lidhur me gjetjet e relatuara dhe kërkesat e bëra nga Komisioni që lidhen me shqyrtimin/gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore civile prej tij, si më poshtë vijon:

i) në lidhje me pretendimin e moszhvillimit të hetimit të plotë e të gjithanshëm të çështjes: Gjykata ka hetuar në mënyrë shteruese faktin, duke marrë në analizë të gjitha provat e paraqitura nga palët dhe ka arritur në përfundimin se paditësi duhet të përfshihet në procedurën e legalizimit, pasi ka qenë një nga kontribuesit për ndërtimin e këtij objekti. Në lidhje me këtë fakt civil, palët ndërgjyqëse kanë pasur qëndrime të ndryshme dhe kanë paraqitur provat përkatëse për të mbështetur pretendimet e tyre. Të gjitha provat janë analizuar në vendim dhe gjykata ka mbajtur qëndrimin e saj në lidhje me faktin civil dhe pretendimet e palëve. Gjykata e Apelit vetëm sa parashtron se Gjykata e Shkallës së Parë ka shkelur nenet 14 dhe 16 të K.Pr.Civile dhe nuk tregon se cili është veprimi apo mosveprimi konkret i kësaj të fundit dhe që vjen në kundërshtim me përmbajtjen e këtyre neneve.

ii) sipas subjektit, Gjykata e Apelit ka qenë e pavëmendshme gjatë leximit të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, kur ka arritur në përfundimin se kjo e fundit nuk ka hetuar në lidhje me faktin se paditësi, A.Y, ka qenë ortak me shtetasin Sh.Y, pasi në vendimin nr. ***, datë 3.11.2017, jo vetëm që parashtrohet ky fakt por analizohet edhe ekstrakti historik i shoqërisë tregtare.

iii) Po kështu, nuk qëndron as pretendimi se Gjykata e Shkallës së Parë nuk ka hetuar në lidhje me ndërgjyqësinë dhe me interesin e shtetasit, Sh.Y, për të qenë palë në këtë gjykim. Gjykata në vendim ka arsyetuar se *paditësi ka pretenduar se është njëri nga bashkëpronarët mbi objektin që ndodhet në procesin e legalizimit dhe duke qenë se kjo procedurë është filluar nga e paditura M.Sh, padia nuk mund të ngrihej veçse ndaj saj. Paditësi kërkon pjesën e tij në bashkëpronësi dhe nuk ka pse të jetë i interesuar për raportet pasurore mes të paditurës dhe shtetasit Sh. Y. Është në vlerësimin e këtij të fundit që të pretendojë ose jo të drejtën e tij mbi këtë pasuri”.*

Në vijim të prapësimeve të tij lidhur me këtë çështje, subjekti ka parashtruar se Gjykata e Apelit, me të drejtën që i jep ligji procedural, mund të mbajë një qëndrim të ndryshëm në raport me qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ta cilësojë këtë të fundit edhe të gabuar, por nuk mund të arsyetojë se gjykata e shkallës së parë nuk është shprehur në lidhje me një fakt apo kërkim të caktuar, ndërkohë që nga përmbajtja e vendimit ka rezultuar ndryshe.

iv) subjekti deklaron se e ka të vështirë të kuptojë se nga është nisur Gjykata e Apelit kur ka arritur në përfundimin se gjykata e shkallës së parë ka mbyllur gjykimin e çështjes, duke shkelur dhe mosrespektuar rregullat procedurale që kanë të bëjnë me faktin që nuk i ka dhënë përgjigje kërkimit të palëve në proces, në kundërshtim me rregullat e parashikuara nga nenet 4, 14, 16 dhe 193 të K.Pr.Civile.

Në lidhje me këtë rrethanë, subjekti ka argumentuar se kërkimi i vetëm i paditësit A.Y është ai që është parashtruar në objektin e padisë dhe gjykata i ka dhënë përgjigje me vendimin përfundimtar, kur ka pranuar kërkesëpadinë, ndërkohë që gjatë gjykimit në shkallë të dytë nuk rezulton të ketë pasur asnjë pretendim nga paditësi në lidhje me këtë fakt.

Po kështu, sikurse shihet edhe nga përmbajtja e vendimit nr.***, datë 3.11.2017, gjykata e shkallës së parë i ka dhënë përgjigje një për një të gjitha pretendimeve/prapësimeve të të paditurit, M.Sh. Dy

nga prapësimet e së paditurës, M.Sh, janë ato që janë cituar edhe më sipër dhe që lidhen me legjitimitimin aktiv dhe pasiv të padisë dhe ndërgjyqësinë, të cilave, sikurse ka cituar në paragrafët përkatës, u është dhënë përgjigje nga gjykata.

Në vijim, subjekti ka cituar edhe pjesët e tjera të vendimit, në referim të të cilave, sipas tij, gjykata u ka dhënë përgjigje në mënyrë shteruese të gjitha pretendimeve/prapësimeve të tjera së të paditurës M.Sh.

v) në vijim, në lidhje shtetasin Sh.Y që duhet të kishte cilësinë e të paditurit në gjykim, ka arsyetuar se i vetmi rast kur gjykata duhet të ketë një rol të caktuar në formimin e ndërgjyqësisë dhe posaçërisht në personat që duhet të kenë cilësinë e të paditurit, është ai i parashikuar nga neni 161/ç i K.Pr.Civile dhe që lidhet me bashkëndërgjyqësinë e detyrueshme. Bashkëndërgjyqësia e detyrueshme është vetëm në rastet e përcaktuara në mënyrë taksative në ligj (p.sh. rasti i gjykimit për pjesëtimin e sendit në bashkëpronësi) dhe nuk është se vlerësohet rast pas rasti nga gjykata, qoftë kjo edhe Gjykata e Apelit. Pra, bashkëndërgjyqësia e detyrueshme nuk është e tillë që mbetet në çmimin e gjykatës për t'u vlerësuar, por ajo ekziston dhe formohet vetëm në rastet kur ligji e parashikon shprehimisht.

Po kështu, kanë qenë vetë palët ndërgjyqëse, duke përfshirë edhe të paditurën, M.Sh, që nuk kanë vlerësuar të kërkojnë thirrjen e tij në cilësinë e personit të tretë, edhe pse kanë pasur dijeni të plotë për marrëdhëniet e tyre me njëri-tjetrin.

Si rrjedhim, në përfundim të prapësimeve subjekti ka argumentuar se, gjykata, për arsye e cituara më sipër, si dhe duke iu referuar objektit të padisë dhe kërimit konkret të paditësit A.Y, për përfshirjen e tij në procedurën e legalizimit, për shkak të kontributit financiar për ndërtimin e objektit, nuk ka vlerësuar që ky proces gjyqësor duhet të zhvillohet edhe në prani të shtetasit Sh.Y, pasi nuk rezulton të ketë interes për çështjen, përveç faktit që është bashkëshorti i së paditurës M.Sh.

Vlerësimi i Komisionit për këtë denoncim

69. Komisioni, pasi vlerësoi me objektivitet shpjegimet dhe provat e depozituara/të administruara, çmon se subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar në nivel ligjor dhe në mënyrë bindëse mbi gjetjet e relatuara që lidhen me përfundimet e nxjerra nga Gjykata e Apelit në shqyrtimin e çështjes objekt denoncimi, dhe si rrjedhojë nuk konstaton problematika thelbësore, të cilat do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale të gjyqtarit Taulant Banushi. Trupi gjykues, arrin në përfundimin se në shqyrtimin e kësaj çështjeje gjyqësore civile, vendimi është marrë bazuar në bindjen e brendshme të gjyqtarit, në interpretimin dhe analizimin e provave dhe ligjit të zbatueshëm.

Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional

70. Si përfundim, në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, denoncimeve të depozituara nga publiku, 5 çështjeve të tjera gjyqësore të trajtuara, shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje të përsëritura e të qenësishme të natyrës procedurale, gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, të tilla që mund të çonin në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale.

Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

V. KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

71. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, në raportin dhe në rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se:

- a. subjekti arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. subjekti arrin nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Taulant Banushi, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 30.3.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Roland ILIA

Kryesues

Pamela QIRKO

Relatore

Etleda ÇIFTJA

Anëtare

Amela Idrizi

Sekretare gjyqësore

ANEKS 1 - TABELA PËRMBLEDHËSE E ANALIZËS FINANCIARE

	Nga 01.10.2003 - 31.12.2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
A) PASURI	2	0	2,001,144	1,626,542	44,477	1,085,372	886,837	-42,387	998,580	5,000,419	1,535,020	2,966,248	2,673,145	1,407,061
Apartament banimi në Fier, porositur nw vitin 2012										5,000,000				
Ndryshim likuiditeti	2	0	2,001,144	1,626,542	44,477	1,085,372	886,837	-42,387	998,580	419	1,535,020	2,966,248	2,673,145	1,407,061
B) DETYRIME	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2,800,000	0	0	0	0
Detyrim I mbetur shoqërisë së ndërtimit										2,800,000				
C) PASURI NETO (A-B)	2	0	2,001,144	1,626,542	44,477	1,085,372	886,837	-42,387	998,580	2,200,419	1,535,020	2,966,248	2,673,145	1,407,061
D) TË ARDHURA	123,316	778,049	2,795,821	2,169,168	2,091,351	3,443,616	3,185,692	2,108,506	2,639,705	3,523,438	5,504,220	4,532,912	4,205,141	3,718,440
Të ardhura nga ushtrimi i detyrës, subjekti i rivlerësimit	123,316	778,049	786,406	846,712	811,282	867,067	892,777	906,334	982,672	961,925	964,590	1,165,763	1,215,059	1,190,807
Të ardhura nga paga si pedagog Universiteti ***, subjekti i rivlerësimit					21,600	793,485	995,175	403,080	258,390		237,150			
Të ardhura nga ushtrimi i aktivitetit - Farmaci *** bashkëshortja e subjektit			1,739,415	1,130,314	866,708	1,294,829	742,140	549,511	1,170,466	2,012,186	2,190,600	2,784,325	2,337,855	1,980,690
Të ardhura nga paga- ushtrimi i aktivitetit Farmaci *** bashkëshortja e subjektit				157,600	337,965	367,734	367,734	-	-	190,266	368,788	400,548	400,548	507,060
Të ardhura nga ISSH, bashkëshortja e subjektit			70,000	34,542					25,200	112,900				
Të ardhura nga interesat bankare të depozitave me afat.					53,796	120,501	187,866	249,581	202,977	246,161	243,092	182,276	251,679	39,883
Të ardhura nga shitja e apartamentit në Fier (I përfituar 1/3 nga NKB)											1,500,000			
Të ardhura nga shitja e autoveturës tip ***, Shitur datë 9.3.2005			200,000											
E) SHPENZIME	46,289	187,728	303,758	328,671	409,860	409,860	725,351	562,551	551,705	930,646	3,713,926	1,027,899	1,043,079	1,277,458
Shpenzime jetike	46,289	187,728	303,758	328,671	409,860	409,860	409,860	409,860	478,170	564,096	564,096	879,992	897,104	940,368
Shpenzime për pagesën e kështit të dytë ndaj shoqërisë së ndërtimit											2,800,000			
Shpenzime për mobilim										200,000	200,000			
Shpenzime për shkollimin e fëmijëve									66,620	166,550	149,830	126,890	132,210	134,185
Shpenzime udhëtimi jashtë vendit	0	0	0	0	0	0	315,491	152,691	6,915	0	0	21,017	13,765	202,905
Balanca e fondeve (D-C-E)	77,025	590,321	490,919	213,955	1,637,014	1,948,384	1,573,504	1,588,342	1,089,421	392,374	255,274	538,766	488,917	1,033,921